



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 67 regjistër (JR)
Datë 09.11.2021

Nr. 28 i vendimit
Datë 05.06.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|------------------------|-----------------|
| Sokol Çomo | Kryesues |
| Ina Rama | Relatore |
| Albana Shtylla | Anëtare |
| Rezarta Schuetz | Anëtare |
| Natasha Mulaj | Anëtare |

- mori në shqyrtim në seancë në dhomë këshillimi, më datë 05.06.2024, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Albert Spiro, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 419, datë 12.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 42 dhe neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e

mosmarrëveshjeve administrative”; Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë; dhe ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi në datën 05.06.2024, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, me anë të të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 419, datë 12.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Albert Spiro (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për shkak të funksionit gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

3.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: *(i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) ka mosdeklarim pasurie ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

3.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka

kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në raportin e dërguar në Komision, DSIK-ja ka konstatuar se nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Pavarësisht raportit të Grupit të Punës të DSIK-së, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit ka rezultuar se konstatimet për kontrollin e figurës janë të sakta.

3.2.i. Nisur nga informacionet e marra nga organet verifikuese, Komisioni ka hetuar lidhur me personin tjetër të lidhur, z. A. H.¹, duke administruar informacion dhe dokumentacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe Prokuroria pranë kësaj gjykate. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni ka konstatuar se personi tjetër i lidhur nuk është akuzuar për vepra penale të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale dhe pikës 1, të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, që mund të vlerësohet si kontakt i papërshtatshëm nga subjekti i rivlerësimit dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e trupës gjyqësore në vendimet gjyqësore të marra ndaj tij.

3.3. KLGj-ja, si organ ndihmës për vlerësimin profesional në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka dërguar në Komision raportin për vlerësimin profesional për subjektin e rivlerësimit Albert Spiro, duke konkluduar se ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, si dhe në arsyetimin ligjor. Komisioni ka kryer një hetim të pavarur lidhur me ankesat e depozituara në KLD, të gjitha aktet e tjera ligjore të analizuar nga KLGj-ja, si dhe për 12 denoncimet nga publiku, duke kërkuar prej subjektit shpjegime për problematikat e konstatuara. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, pasi kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Albert Spiro, për të tria kriteret e rivlerësimit, të pasurisë, kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale, me vendimin nr. 419, datë 12.07.2021, vendosi shkarkimin e subjektit nga detyra bazuar në konkluzionet për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Lidhur me këtë kriter, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në përfundimet si vijojnë:

¹ Siç do të analizohet në vijim të këtij vendimi, në DIPP-në 2011 subjekti ka deklaruar një hua të marrë prej shtetasit A. H. në vlerën 50.000 euro, për rrjedhojë i sipërcituari ka marrë cilësinë e personit tjetër të lidhur.

- i. Deklarime jo të sakta dhe në përputhje me ligjin dhe mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë apartament me sip. 98 m² dhe garazh me sip. 25 m², në Vlorë, duke u gjendur në kushtet e germave “a” dhe “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë apartament me sip. 95 m² dhe 2 garazhe, në {***}, Tiranë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë autoveturë tip “Daimler Chrysler” (Mercedes-Benz), me vlerë 3.850 euro, prodhim i vitit 2004, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- iv. Deklarime jo të sakta dhe në përputhje me ligjin, në lidhje me deklarin e gjendjes së likuiditeteve cash në deklaratën vetting të vitit 2017, duke u gjendur në kushtet e germave “a” dhe “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- v. Mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, ndër vite, sipas analizës financiare të Komisionit, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), kundër vendimit të sipërpërmbledhur. Subjekti pretendoi se vendimi është marrë në shkelje procedurale dhe materiale duke cenuar rëndë procesin e rregullt ligjor, përcaktuar në nenin 6 të KEDNj-së dhe nenin 42 të Kushtetutës, në vlerësim të gabuar të provave të administruara gjatë hetimit administrativ dhe në interpretim të gabuar të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Përmes ankimit, subjekti ka kërkuar që Kolegji të vendosë:
 - i. Gjykimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 419 vendimi, datë 12.07.2021, të Komisionit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Albert Spiro.
 - ii. Shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave.
 - iii. Ndryshimin e vendimit nr. 419, datë 12.07.2021, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të tij.
6. Për sa i përket argumenteve për cenim të procesit të rregullt dhe të aspekteve procedurale të procesit të rivlerësimit të tij, subjekti potencon se trupi gjykues i Komisionit: (i) nuk ka qenë i pavarur dhe i paanshëm; (ii) ka qenë i njëanshëm, diskriminues, nuk ka zbatuar parimin e kontradiktoritetit, pasi vendimi është bazuar vetëm në provat e marra kryesisht në shkelje të rëndë të parimit të paanësisë; (iii) nuk ka respektuar parimin e sigurisë juridike, proporcionalitetit dhe objektivitetit; (iv) ka vlerësuar në mënyrë të kundërligjshme kriterin e pasurisë si “deklarim të pamjaftueshëm”, në kuadër të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk rezulton ekzistenca e kushtit të dytë kumulativ që kjo dispozitë kërkon, ekzistenca e vlerësimit të kriterit të figurës në nivel të papërshtatshëm për të vijuar detyrën. Sipas subjektit, edhe nëse dy kushtet e përcaktuara nga dispozita do të ishin të ndara, vlerësimi i Komisionit për shkarkimin nga detyra nuk do të ishte

i bazuar, pasi *deklarimi i pamjaftueshëm*, që nënkupton sjelljen më të rëndë të subjektit në lidhje me kriterin e pasurisë, duhet të ketë të njëjtin nivel kundërligjshmërie, sikundër shkeljet e renditura në pikat 1,2, 4 dhe 5, të nenin 61 të ligjit nr. 84/2016.

7. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, subjekti pretendon se konkluzionet e Komisionit janë të gabuara si rrjedhojë e vlerësimit jo të drejtë dhe të paanshëm të provave të depozituara prej tij dhe të atyre të administruara nga vetë Komisioni, si dhe të shpjegimeve të tij. Në mënyrë të përmbledhur, argumentet e subjektit janë si më poshtë.

7.1. Lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 98 m² dhe garazh me sipërfaqe 25 m², në Vlorë, përfundimi i Komisionit për deklarime jo të sakta dhe në përputhje me ligjin, si dhe mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 538.618 lekë, për efekt të llogaritjes së pagesës së tatimit mbi shitjen e pasurisë apartament në Gjirokastër, është i pabazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara. Ka shpjeguar dhe provuar ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Gjirokastër se ka shlyer një vlerë tatimore më të lartë se parashikimet ligjore të kohës, pasi është shitur edhe pasuria e luajtshme (mobilim dhe elektroshtëpiake), për të cilën nuk ka parashikim ligjor që përcakton detyrim tatimor. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratat e pasurisë 2008-2010 të detyrimit financiar të mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese, për sa ka deklaruar detyrimin e *kontratës së blerjes* dhe pagesat e *shlyera çdo vit*, për rrjedhojë kuptohet shumë lehtë vlera e detyrimit të mbetur. Lidhur me pagesën e këstit të fundit, burimi i shumës prej 700.000 lekësh është gjendja *cash* në fund të vitit 2010, e cila ka qenë 1.000.000 lekë, e deklaruar përpara ILDKPKI-së në vitin 2015.

7.2. Lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 95 m² dhe dy garazhe në {***}, Tiranë, përfundimet e Komisionit, se nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave për financimin e kësaj pasurie, janë të pabazuara. Me provat e paraqitura prej tij dhe me ato të administruara nga Komisioni, rezulton se personat e tjerë të lidhur/huadhënësit kanë pasur burime të mjaftueshme për dhënien e huasë prej 50.000 eurosh dhe analizimi i mundësive të tyre për të dhënë këtë hua dhe për të blerë pasuri të tjera të paluajtshme është përtej orientimit të Kolegjit. Lidhur me burimin tjetër të krijimit të kësaj pasurie, kursimet familjare në vlerën 18.000 euro, subjekti argumenton se: (i) huaja prej 500.000 lekësh dhënë prindërve të bashkëshortes në vitin 2004 është kthyer prej tyre në shumën 5.000 euro në vitin 2011, ku diferenca është një ndihmë e ndërsjelltë në kuadrin e marrëdhënieve familjare dhe jo fitim; (ii) shuma 3.000 euro është krijuar nga pakësimi i gjendjes *cash* në euro, e cila në fund të vitit 2010 ka qenë 5.000 euro, deklaruar në ILDKPKI në vitin 2015; (iii) sa i përket pagimit të shumës prej 5.000 eurosh në datën 13.12.2014, mospërditësimi i disa zërave në analizën financiare të Komisionit, si shpenzimet jetike, të arredimit dhe gjendja e kursimeve, kanë pasjellë konkluzionin e gabuar për mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vitin 2014, për kryerjen e këtij shpenzimi dhe për mbulimin e shpenzimeve jetike.

7.3. Lidhur me pasurinë autoveturë tip “Daimler Chrysler” (Mercedes-Benz), me vlerë 3.850 euro, prodhim i vitit 2004, konkluzioni i Komisionit se *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 956.485 lekë* është i bazuar në paragjykim, për sa vlera

e automjetit përcaktohet nga kontrata e shitjes, vërtetësia e së cilës vihet në dyshim prej Komisionit në mënyrë të pabazuar.

7.4. Lidhur me analizën financiare për periudhën 2003-2016, përpos pretendimeve për ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi për pasuritë e sipërcituara, e në këtë kontekst përfshirjen e tyre në vitet respektive, subjekti potencoi pretendimet lidhur me: (i) shpenzimet e arredimit të apartamentit në Vlorë dhe të atij në Tiranë, shpërndarjen e tyre në vite dhe burimin e të ardhurave për to; (ii) shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, në shumicën e rasteve udhëtime disa orësh në Janinë për blerje ushqimesh dhe në farmaci; (iii) shpenzimet jetike, duke reflektuar të dhënat sipas anketës së INSTAT-it sipas rajoneve, për vitet 2002-2007, të rajonit qendror ku klasifikohet qyteti i Gjirokastrës dhe nga viti 2008 të rajonit bregdetar, ku klasifikohet qyteti i Vlorës. Subjekti parashtrroi se sipas raportit të audituesit A. M., ku janë përfshirë të ardhurat nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë dhe janë analizuar në mënyrë profesionale treguesit, për periudhën 2003-2016, rezultati del me balancë pozitive në vlerën 2.511.434 lekë dhe jo me balancë negative prej (-) 10.243.466 lekësh.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit. Për rrjedhojë, çështja me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Albert Spiro, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh² nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

² Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi nr. 419, datë 12.07.2021, i Komisionit, për rivlerësimin e subjektit Albert Spiro, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet shërbimit postar, konfirmuar marrja e tij në datën 18.10.2021, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Ndaj vendimit të sipër referuar, subjektit i rivlerësimit ka paraqitur ankim, i cili është administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 02.11.2021.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), gjykimi i kësaj çështje u bë në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, edhe për shkak të faktit se nuk u konstatuan shkelje procedurale që mund të justifikonin kalimin e çështjes për shqyrtimin në seancë gjyqësore publike, sipas arsytimit në vijim.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislationit

11. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi objekt ankimi është marrë mbi bazën e një hetimi administrativ të paplotë, të pabazuar në Kushtetutë dhe ligj dhe konkluzioni i Komisionit vjen si pasojë e shkeljeve të parimeve themelore procedurale, pasi procesi i zhvilluar për të është i parregullt, në kuptim të nenit 42 dhe nenit 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, nenit 4, pikat 5 dhe 6 dhe nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”), nën dritën e dispozitave përkatëse, i mori në analizë të gjitha këto pretendime të subjektit dhe arriti në përfundimin që asnjë prej tyre nuk qëndron. Nga analiza e kryer mbi bazën e akteve në fashikull, rezulton se procesi i kryer për subjektin e rivlerësimit Albert Spiro ka qenë në përputhje dhe në përmbushje të gjithë garancive kushtetuese, ligjore e të angazhimeve nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë për proces të rregullt ligjor. Në vijim shtjellohet në detaj arsyetimi mbi të cilin mbështetet ky konkluzion.

11.1. Subjekti pretendon se trupi gjykues i Komisionit nuk ka qenë i pavarur dhe i paanshëm. Duke referuar në kriteret e përcaktuara nga GjEDNj-ja në çështjen *Volkov kundër Ukrainës*, subjekti fokusoï pretendimin e tij në mospërfaqësimin e gjyqtarëve në mes anëtarëve të Komisionit, mënyrën e emërimit të tyre përkundrejt rëndësisë së garancive ndaj presioneve të jashtme, mandatin e limituar pa të drejtë rizgjedhje, rrethana që, sipas tij, kanë krijuar një Komision jo të pavarur, një gjykatë të formuar jo sipas ligjit, në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së. Sipas subjektit, parashikimet ligjore për të hetuar dhe gjykuar të zbatuara prej Komisionit kanë sjellë paragjykimin e çështjes dhe marrjen e vendimit bazuar në dyshime dhe hamendësime, në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor. Mënyra si Komisioni ka analizuar provat tregon njëanshmëri jo vetëm në dukje, por edhe konkrete, pretendon subjekti. Duke u shprehur se shkeljet e rënda procedurale hyjnë në rastet e parashikuara në nenin 53, germa “ç”, nenin 54, germa “b” të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenin 467, paragrafi i parë, germa “ b” të Kodit të Procedurës Civile, edhe për këto shkaqe, subjekti kërkoi deklarimin e pavlefshëm të vendimit të Komisionit, konstatimin e shkeljeve të rënda procedurale dhe korrigjimin e tyre, duke e rigjykuar çështjen prej Kolegjit, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

11.1.1. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për përbërjen dhe funksionet e Komisionit dhe emërimin e anëtarëve të tij, rezulton se Kolegji i ka trajtuar ato gjerësisht në jurisprudencën e tij dhe i ka vlerësuar të pabazuara³. Duke sjellë në vëmendje se kuadri kushtetues e ligjor mbi të cilin kryhet rivlerësimi, përfshirë edhe mënyrën e funksionimit të Komisionit, ka kaluar testin e gjykimit kushtetues⁴, dhe se për aspektin e zbatimit praktik të tij ka mbajtur qëndrim edhe GjEDNj-ja në disa vendime për çështje të shqyrtuara mbi bazë të ankimeve të subjekteve të rivlerësimit⁵, trupi gjykues rithekson qëndrimin e mbajtur nga Kolegji se në përmbushjen e veprimtarisë së përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, ligjshmëria, pavarësia dhe paanësia e Komisionit nuk mund të jenë objekt kontestimi.

11.1.2. Lidhur me pretendimet për mënyrën se si Komisioni ka analizuar provat, të cilat do të trajtohen gjerësisht në vijim, si pjesë e analizës së shkaqeve të ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i vlerëson të pabazuara. Nën dritën e parashikimit të pikës 4, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i provave, deklaratimeve në deklaratat periodike e atyre në deklaratën e pasurisë *vetting*, përfaqëson në thelb autoritetin e Komisionit për marrjen e vendimit, bazuar në dokumente të njohura, të besueshme dhe në pajtueshmëri me provat e tjera. Edhe nëse do të prezumohej e provuar që konkluzionet e Komisionit janë bazuar në dyshime apo hamendjesime, siç pretendon subjekti, për sa vendimi i nënshtrohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit, të gjithë pretendimet dhe kërkimet e tij në këtë drejtim do të zgjidhen nëpërmjet vendimit përfundimtar të Kolegjit. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për cenim të procesit të rregullt ligjor, bazuar vetëm në mënyrën dhe peshën që Komisioni u ka dhënë provave të ndryshme dhe për të deklaruar të pavlefshëm vendimin e Komisionit për këto shkaqe, vlerësohen nga trupi gjykues të pabazuara.

11.2. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, kërkesat e tij nuk janë shqyrtuar, por vetëm janë pasqyruar, nuk është marrë parasysh asnjë provë e paraqitur prej tij pa arsyetuar shkaqet e mospranimit të tyre, mungon arsyetimi për konstatimet dhe përfundimet, nuk ka pasur të drejtën e kundërshtimit të provave të krijuara nga Komisioni, nuk është njohur me ekspertët që kanë kryer vlerësimet ekonomike, si dhe nuk i është dhënë e drejta të verifikojë kushtet e mospasjes së konfliktit të interesit të tyre, me pasojë cenimin e të drejtës për një mbrojtje efektive.

³ Shih vendimet e Kolegjit, ndër tjerë, nr. 8/2021 (JR), nr. 19/2022 (JR); nr. 23/2022 (JR); nr. 32/2023 (JR); nr. 1/2023 (JR) dhe nr. 54/2023 (JR.)

⁴ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 13.04.2007; nr. 7, datë 11.03.2008; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 23, datë 04.11.2008 dhe nr. 78, datë 12.12.2017, ku gjykata ka analizuar se: “[...] Sipas nenit 179/b të Kushtetutës sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit [...]. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra, organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së [...]”.

⁵ Shih vendimin e GjEDNj-së Xhoxhaj kundër Shqipërisë, parag. 314, 316, lexuar së bashku me parag. 299-300; Sevdari kundër Shqipërisë, parag. 117-199.

11.2.1. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues konstatoi se pretendimet e ngritura nga subjekti për arsyetimin e vendimit të Komisionit janë të pabazuara. Vendimi i Komisionit përmbush kërkesat e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, si në aspektin formal, përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese, me gjithë parashikimet për përbërjen e tyre, pra, edhe në atë përmbajtësor. Referuar akteve në fashikull, rezulton që në vendim, Komisioni ka referuar shpjegimet e provat e paraqitura nga subjekti, sipas kërkesave të neneve 47 dhe 48 të Kodit të Procedurave Administrative⁶, ka analizuar, arsyetuar dhe dhënë vlerësimin për to në raport me provat e tjera të administruara. Fakti që përfundimet mbi të cilat mbështetet vendimi bazohen në një vlerësim të provave të ndryshëm nga sa pretendohet prej subjektit, nuk mund të përbëjë shkak për të pretenduar për veprime të kryera në kundërshtim me garancitë kushtetuese për proces të rregullt. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, lidhur me mosarsyetimin e vendimit prej Komisionit, u gjet prej trupit gjykues i pabazuar.

11.2.2. Gjithashtu, pretendimet e subjektit se nuk ka pasur të drejtën e kundërshtimit të provave të krijuara nga Komisioni, trupi gjykues i gjen të pabazuara dhe të pambështetura. Nga shqyrtimi i akteve në fashikuj, konstatohet se me rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, ku pasqyrohen të gjitha provat e administruara nga Komisioni, si dhe gjetjet për të cilat i ka kaluar barra e provës, subjektit i janë përcjellë analiza financiare (aneks 01) dhe metodika e përdorur (aneks 02), si dhe i janë njoftuar të drejtat e garantuara nga ligji në këtë fazë të procedurës, ndër to edhe për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Referuar prapësimeve të paraqitura, rezulton se lidhur me barrën e provës subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara, si dhe ka paraqitur provat që ka çmuar të nevojshme. Lidhur me analizën financiare të Komisionit, subjekti ka kërkuar rishikim të zërave të ndryshëm, duke u bazuar në raportin e ekspertimit kontabël, hartuar nga audituesi ligjor A. M., sipas porosisë/orientimit të tij, të cilin e ka paraqitur si provë. Gjithashtu, në seancën dëgjimore, pa asnjë pengesë subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pretendimet e tij lidhur me gjetjet e Komisionit dhe provat e administruara, përfshirë të dhënat zyrtare mbi të cilat është bazuar përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për cenim të parimit të kontradiktoritetit vlerësohet i pabazuar.

11.2.3. Lidhur me pretendimin se nuk është njohur me ekspertët që kanë kryer vlerësimet ekonomike dhe nuk i është dhënë e drejta të verifikojë kushtet e mospasjes së konfliktit të interesit të tyre, trupi gjykues, *së pari*, rithekson qëndrimin e mbajtur nga Kolegji⁷se Komisioni nuk ka detyrimin për t'i bërë të njohur subjektit këshilltarët ligjor apo ekonomik, pasi bazuar në nenet 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016, ata ndihmojnë trupin gjykues në studimin dhe përgatitjen e çështjes,

⁶ Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 47 të titulluar “E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime” parashikon: “Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes” dhe në nenin 48 të titulluar “Detyrimi i vlerësimit” parashikon: “Organi publik, në çdo rast, është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij Kodi”.

⁷ Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit nr. 13/2019 (JR).

por nuk kanë asnjë kompetencë vendimmarrëse gjatë procesit të rivlerësimit. *Së dyti*, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se në dispozitat e ligjit nr. 84/2016, që rregullojnë detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Shërbimit Ligjor, nuk parashikohet lidhur me deklarin e konfliktit të interesit prej këshilltarëve ligjor apo ekonomik me rol ndihmës dhe këshillues për organet e rivlerësimit. Ligji nr. 84/2016, në nenin 27 “Garantimi i paanësisë”, parashikon detyrimin për deklarin dhe shmangie të konfliktit të interesit, për shkaqe të përmendura në nenin 30 të ligjit nr. 44/2015 apo të ligjit nr. 9367/2005, vetëm për anëtarët e organeve të rivlerësimit. Sa më sipër, trupi gjykues nuk konstaton asnjë fakt apo rrethanë konkrete, të cilat do të ilustronin pretendimin e subjektit për cenim të së drejtës për një mbrojtje efektive, për rrjedhojë e vlerëson pretendimin e subjektit të pabazuar.

11.3. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni nuk ka respektuar parimet e sigurisë juridike, të proporcionalitetit dhe objektivitetit, me argumentet se ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 34/2 dhe ligji nr. 96/2016 “Për statusin e magjistratëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 117/1, në procedurat kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, parashikojnë afate kohore parashkrimi deri në pesë vjet për shkelje disiplinore ose shkelje të tjera. Duke referuar qëndrimin e mbajtur nga GjEDNj-ja, se periudhat e kufizimit mbi të cilat mund të merren masat disiplinore i shërbejnë sigurisë juridike dhe mbrojnë “të akuzuarit” nga pretendime të cilat mund të jenë të vështira për t’u kundërshtuar, subjekti parashton se shkaqet kryesore të vendosura në themel të vendimmarrjes i përkasin viteve 2008, 2009 dhe 2011, ndërkohë për pasuritë e krijuara gjatë ushtrimit të detyrës, sipas deklarimeve në deklaratat e pasurisë dhe deklaratën e rivlerësimit *vetting*, shpenzimet janë në shumën 6.553.618 lekë dhe të ardhurat familjare, vetëm nga pagat për periudhën 1998-2016, kanë qenë 23.142.150 lekë.

11.3.1. Kolegji në jurisprudencën e tij ka theksuar se zbatimi i parimit të sigurisë juridike nuk ka karakter absolut, por ai është proporcionalisht i kufizuar për shkak të miratimit, nëpërmjet parashikimeve kushtetuese të rregullave që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar dhe përcaktojnë edhe kufizimet e posaçme të të drejtave themelore që shkaktohen për shkak të kryerjes së këtij procesi në emër të mbrojtjes së interesit publik⁸. Në vështirim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me objekt, ndër të tjera, rregullimin lidhur me përgjegjësi disiplinore, civile dhe penale e magjistratëve, duke i parashikuar normat në dispozita të veçanta të Kreut I-rë të tij, përcaktohet qartë se përgjegjësia disiplinore është pasojë e veprimeve të caktuara, të cilat kanë të bëjnë me ngjarje faktike, të plota, të një momenti të caktuar, ndërsa procesi i rivlerësimit përbën një procedurë të posaçme me objektiva të tjerë të parashikuar nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit. Në këtë drejtim, trupi gjykues sjell në vëmendje që, sipas nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016⁹, procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për sa i përket kriterit të

⁸ *Shih vendimin e Kolegjit nr. 23/2022 (JR).*

⁹ “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarin dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”.

vlerësimi të pasurisë, duhet të identifikojë subjektet që kanë në pronësi ose përdorim *pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht* ose ata që *nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht* pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Nga leximi harmonik i parimeve, mbi të cilat kryhet kontrolli i pasurisë së subjekteve në procesin e rivlerësimit dhe standardeve të përcaktuara të qartë, nuk mund të pretendohet për cenim të parimit të sigurisë juridike.

11.3.2. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se në të njëjtën linjë, në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, GjEDNj-ja ka arsyetuar se vendosja e kufijve kohorë do të cenonte kapacitet e autoriteteve për të vlerësuar ligjshmërinë e totalit të pasurive të përfituara nga një subjekt gjatë karrierës së tij profesionale dhe që, për shkak të specifikës që ka vlerësimi i pasurisë përkundër hetimeve të zakonshme disiplinore, *kërkonin një shkallë më të lartë fleksibiliteti për shtetin e paditur*, për zbatimin e kufizimeve ligjore, në përputhje me objektivin e rikthimit dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe sigurimin e një niveli të lartë integriteti që pritet nga anëtarët e gjyqësorit¹⁰.

11.4. Subjekti pretendoi se sipas ligjit të kohës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, nr. 9049/2003, largimi nga detyra parashikohej si masë disiplinore vetëm për rastet e refuzimit për deklarim dhe nëse në procesin e rivlerësimit kalimtar subjekteve u jepet masë disiplinore për pasaktësitë apo shkeljet administrative, që mund të jenë kryer në deklaratat vjetore të pasurisë, do të cenoheshin parimet *nullum crimen nulla poena sine lege* dhe *means rea*. Sipas subjektit, ligji nr. 84/2016 nuk ka parashikuar masa të nevojshme procedurale për të parandaluar zbatimin arbitrar të ligjit material, duke cenuar dukshëm parimin e sigurisë juridike. Subjekti pretendon se nuk ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë e, nëse ka pasaktësi të konstatuara, Kolegji duhet të mbajë parasysh se janë të paqëllimshme e pa asnjë pasojë. Pasaktësitë, që në rastin e tij *janë fare të parëndësishme pasi kanë të bëjnë me mosdeklarim të pakësimit të të ardhurave cash që janë vlerësuar të ligjshme*, nuk mund të konsiderohen deklarim i rremë, pasi mungon dashja apo qëllimi.

11.5. Lidhur me këto pretendime, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit, *së pari*, për marrjen në konsideratë të të gjithë deklarimeve të subjekteve të rivlerësimit, për arritjen në një konkluzion të drejtë e të bazuar në një kontroll të plotë të tyre, në funksion të kontrollit të vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve të tij në vite¹¹. *Së dyti*, përkundër pretendimeve për kohën e kaluar, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk është shkarkuar nga detyra për shkak të deklarimeve të kryera në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, por se, sipas analizës së kryer, nën dritën e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës¹² dhe nenit 61, pika

¹⁰ *Shih vendimet e GjEDNj-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafi 349; çështja Thanza kundër Shqipërisë, paragrafi 107.*

¹¹ *Shih vendimet e Kolegjit nr. 19/2019(JR) dhe nr. 23/2019 (JR).*

¹² *Pikat 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikojnë: "1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohej ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. [...] "3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive*

3 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konkluduar se ai nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit për pasuritë e deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit *vetting*, kontrolli duhet të përfshijë edhe krahasimin me deklaratimet ndër vite, për sa neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se deklaratat periodike vjetore të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Për rrjedhojë, trupi gjykues vëren se procesi i rivlerësimit për subjektin nuk përbën në asnjë këndvështrim cenim të parimit të sigurisë juridike dhe i vlerëson të pabazuara pretendimet e subjektit për cenimin e këtij parimi.

11.6. Lidhur me pretendimet për cenim të parimeve *nullum crimen, nullum poena sine lege* dhe *mens rea*, trupi gjykues sjell në vëmendje që këto parime i referohen procesit penal, ndërsa procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve i përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, si një masë e *jashtëzakonshme*, ka natyrë administrative, në funksion të qëllimit për të qëndruar në detyrë magistratët, të cilët rezultojnë të përshtatshëm për të ushtruar funksionin e dhënies së drejtësisë. Në të njëjtën linjë, GjEDNj-ja ka vlerësuar se procesi i rivlerësimit nuk përbën proces penal, bazuar në ligjin mbi të cilin mbështetet, natyrën e veprimeve të marra në analizë, subjektet të cilët i nënshtrohen dhe seriozitetin e sanksionit¹³. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se argumentet e subjektit të rivlerësimit, për të kontestuar legjitimitetin e vlerësimit pasuror të kryer gjatë procesit të tij të rivlerësimit, janë të pabazuara.

11.7. Subjekti pretendoi se Komisioni ka vlerësuar në mënyrë të kundërligjshme kriterin e pasurisë si *deklarim të pamjaftueshëm*, në kuptim të nenit 61, pika 3, pasi nuk rezulton ekzistenca e kushtit të dytë kumulative, që kjo dispozitë kërkon qartësisht, vlerësimi i kriterit të figurës në nivel të papërshtatshëm për të vijuar detyrën. Sipas tij, edhe nëse kushtet e përcaktuara në nenin 61, pika 3 do të ishin të ndara, sjellja e subjektit në kuadër të deklaratimit të pamjaftueshëm duhet të jetë e tillë që të ketë të njëjtin nivel kundërligjshmërie, sikundër në shkeljet e renditura në pikat 1, 2, 4 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti potencoi se përmes analizës financiare ka provuar se vlera e pasurive të tij është plotësisht e justifikuar me pagesat e kryera se është 30% më pak se të ardhurat e ligjshme dhe, duke pasur parasysh sjelljen e tij të sinqertë në raport me deklarin dhe trajtimin e të ardhurave, Komisioni duhet të kishte zbatuar parimin e *dyshtit të pasurisë së ligjshme*, koncept i përcaktuar në kuadrin kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit kalimtar, duke pasur parasysh periudhën e gjatë kohore për të cilën do të kryhej procesi i rivlerësimit, shkallën e lartë të informalitetit, lejuar prej vetë shtetit, për sa plotësohet kushti që subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë i besueshëm, të mos jetë përpjekur të fshehë ose paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim.

11.7.1. Lidhur me këto pretendime, që kanë të bëjnë me interpretimin e konceptit të deklaratimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3, vlerësuar në raport me konstatimet e procedurës së

dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj [...]”.

¹³ *Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafin 241 e vijues.*

vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 33, pika 5 e të njëjtit ligj, Kolegji i ka analizuar dhe trajtuar në mënyrë shteruese në jurisprudencën e tij¹⁴, duke i vlerësuar të pabazuara. Sikurse Kolegji ka analizuar, përcaktimet e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, janë autonome dhe secila prej tyre parashikon situatat që passjellin masën disiplinore të shkarkimit, në varësi të rrethanave konkrete. Në funksion të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në pesë situatat ligjore që parashikon neni 61 i ligjit, nënkupton që subjektet e rivlerësimit duhet të shpjegojnë bindshëm se nuk gjenden në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, nuk kanë kontakte të papërshtatshme, nuk kanë kryer deklaram të pamjaftueshëm të vlerësimit të pasurisë, nuk kanë kryer deklaram të pamjaftueshëm të kontrollit të figurës, janë të aftë profesionalisht dhe që me sjelljet dhe veprimet e tyre nuk kanë cenuar besimin e publikut të drejtësia. Sa më sipër, pretendimi i subjektit për aplikim të *dyfishit të pasurisë së ligjshme*, për sa ai nuk është përpjekur të fshehë ose paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim, është interpretim i pambështetur në frymën dhe parashikimet e ligjit dhe pretendon të anashkalojë parashikimet ligjore të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

11.8. Lidhur me pretendimet e moszbatimit të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi dhe akteve në fashikuj, trupi gjykues i vlerëson pretendime të pabazuara. Kolegji në jurisprudencën e tij ka mbajtur qëndrim se parimi i proporcionalitetit, i parashikuar në pikën 1, të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, që ka për qëllim të sigurojë që masa disiplinore të jetë në proporcion me shkeljen e konstatuar, është një prej tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit dhe nuk mund të gjejë zbatim si parim i veçantë dhe i vetëm i rivlerësimit¹⁵. Në vendimin objekt ankimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Albert Spiro, nga 10 pasuri objekt kontrolli, për 5 prej tyre ka dështuar të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite në një vlerë prej (-) 10.243.466 lekësh, ka bërë deklarime jo të sakta dhe në përputhje me ligjin për gjendjen e likuiditeteve *cash*, për rrjedhojë, në këto rrethana konkrete faktike e ligjore, por edhe në ato të cilat kanë rezultuar nga gjykimi i çështjes në Kolegj, siç do të analizohet në vijim, nuk gjejnë bazueshmëri pretendimet për aplikim të parimeve të sipërcituara.

12. Në përmbledhje të sa më sipër, për pretendimet e subjektit të rivlerësimit me natyrë procedurale, duke pasur parasysh parimet e procesit të rregullt ligjor, referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, GjEDNj-së dhe jurisprudencës së Kolegjit, mbi gjykimin kontradiktor dhe barazinë e armëve, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e subjektit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor nuk qëndrojnë dhe rezultojnë të pambështetura në ligj dhe në aktet në fashikull.

¹⁴ Shih vendimet e Kolegjit nr. 19/2022(JR) dhe nr. 25/2021 (JR).

¹⁵ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndër të tjerë, nr. 2/2020 (JR), datë 27.02.2020, nr. 20/2020 (JR), datë 08.09.2020 dhe nr. 36/2020 (JR), datë 16.12.2020.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

C.1 Pasuria apartament banimi me sip. 98 m² dhe garazh me sip. 25 m², lagjja “{***}”, rruga “{***}”, pranë shkollës 9-vjeçare “{***}”, Vlorë

13. Në deklaratën *vetting*, subjekti i deklaron këto pasuri të blera nga shoqëria “{***}” ShPK, pasqyron të dhënat e kontratave të shitjes të vitit 2011, vlerat respektive 5.500.000 lekë apartamenti¹⁶ dhe 1.000.000 lekë garazhi dhe burim krijimi deklaron të ardhurat nga shitja e një apartamenti në Gjirokastrë në shumën 6.200.000 lekë dhe kursime familjare nga pagat. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2011 (në vijim “DIPP”), subjekti deklaron shtuar 2 apartamente banimi 1+1 (një banesë) + garazh, blerë me kontratat përfundimtare të shitjes në datën 07.01.2011, në vlerën 6.500.000 lekë = 51.000 euro. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti deklaron *shitur apartament banimi 2+1 me sipërfaqe 104 m² në Gjirokastrë - shuma e përfutuar është deklaruar në vitet 2009-2010*. Në DIPP-të e viteve 2008 dhe 2009, subjekti deklaron këstet e përfuturara si kapar nga premtimi për shitje i pasurisë apartament banimi në Gjirokastrë dhe pakësimin e tyre për pagesa në bazë të kontratës paraprake të shitblerjes të këtyre pasurive.
14. Komisioni ka konkluduar për *deklarime jo të sakta dhe në përputhje me ligjin dhe mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë apartament me sip. 98 m² dhe garazh me sip. 25 m² në Vlorë, duke u gjendur në kushtet e germave “a” dhe “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016*, bazuar në përfundimet: (i) lidhur me të ardhurat e përfuturara nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë prej 6.200.000 lekësh, subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 563.618 lekë, për efekt të llogaritjes së pagesës së tatimit mbi shitjen, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) për këstin e parë në vlerën 3.200.000 lekë (26.000 euro), paguar në rrugë bankare në datën 15.12.2008, subjekti ka rezultuar me mjaftueshmëri dhe në përputhje me shumën e deklaruar në DIPP-në 2008 dhe me burimin e deklaruar - shitje e apartamentit në Gjirokastrë; (iii) për këstin e dytë në vlerën 2.600.000 lekë, Komisioni ka konstatuar se vlera 2.435.000 lekë ka si burim të ardhurat nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë. Në përfundim, pas analizimit të shpjegimeve të subjektit dhe provave të administruara, Komisioni ka konkluduar se subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të mjaftueshme në vlerën 272.953 lekë, për pagesën e këstit të dytë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; (iv) për këstin e tretë në vlerën 700.000 lekë, për të cilin gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se është paguar në fillim të vitit 2011, në momentin e nënshkrimit të kontratave të shitjes të pasurive, me burim pakësimin e gjendjes së kursimeve *cash*, Komisioni ka konkluduar se subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 700.000 lekë për pagesën e tij, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁶ Subjekti deklaron se fillimisht janë pasqyruar si blerje e dy apartamenteve për të cilët është bërë bashkimi që në ndërtim dhe është regjistruar si një, pranë ZVRPP-së Vlorë në vitin 2014, me nr. pasurie {***}, z. k. {***}. Apartamentet janë blerë nga shoqëria “{***}” ShPK me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.01.2011, dhe garazhi i blerë po nga kjo shoqëri me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.01.2011, është regjistruar pranë ZVRPP-së Vlorë me numër pasurie {***}.

15. Subjekti kundërshton si të pabazuara konkluzionet e Komisionit me argumentet si vijojnë. Lidhur me shumën e përfituar nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë prej 6.200.000 lekësh, subjekti pretendon pretendimet e tij në disa aspekte: (i) kontrata e shitjes është hartuar me çmimin e referencës së shitjes së pasurisë së paluajtshme të zonës dhe është paraprirë nga kontrata e kaparit, të dyja akte publike që tregojnë mungesë qëllimi për fshehjen e vlerës së përfituar dhe për shmangien e detyrimeve tatimore; (ii) diferenca mes çmimit në kontratën e kaparit me atë në kontratën e shitjes vjen për shkak se apartamenti është shitur së bashku me mobilimin dhe pajisjet elektroshtëpiake; si dhe (iii) ka provuar se ka shlyer një vlerë tatimore më të lartë se parashikimet ligjore të kohës për shitjen e pasurisë së paluajtshme apartament. Lidhur me këstin e dytë, subjekti pretendon se duke provuar ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë, në vlerën totale, ka provuar edhe ligjshmërinë e pagesës me këtë burim [1.935.000 lekë në rrugë bankare dhe vlerës 500.000 lekë të tërhequr *cash* në fund të vitit 2009]; vlerën 165.000 lekë ka pasur mundësi ta kursejë nga të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes; shpenzimet e jetesës nuk janë kryer sipas të dhënave të INSTAT-it që i specifikon për secilin rajon e në rastin e tij për rajonin bregdetar; si dhe shpenzimet për arredim janë mbuluar edhe nga pakësimi prej 100.000 lekësh i gjendjes *cash*. Lidhur me pagesën e këstit të fundit në vitin në vitin 2011, në shumën prej 700.000 lekësh, subjekti pretendon se burimi i krijimit të saj është pakësimi i gjendjes *cash* i padeklaruar në DIPP-në 2011 për pakujdesi apo keqinterpretim të rubrikave të deklaratës, por i deklaruar përpara ILDKPKI-së, sipas procesverbalit të vitit 2015, sapo pasaktësia është evidentuar nga ky institucion.
16. Pikësëpari, nga një lexim edhe logjik i përfundimit të Komisionit, trupi gjykues konstaton gabime materiale në pasqyrimin e bazës ligjore ku mbështetet përfundimi. Konkretisht, përpos mosreferimit të pikës përkatëse të dispozitës së referuar – pika 5, e nenit 33 e ligjit nr. 84/2016 – është referuar edhe germa “a”, e pikës 5, të po kësaj dispozite, e cila nuk gjen aplikim duke konsideruar përfundimet pjesore të konkluduara më lart në vendim. Në përfundimet lidhur me secilin prej tri kësteve të paguar për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni në asnjë rast nuk konkludon për deklarime të pasakta të subjektit të rivlerësimit e, për rrjedhojë, ky përfundim i pasqyruar në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë nuk vjen në unitet me sa analizuar dhe konkluduar më lart në vendim lidhur me këtë pasuri. Në kontekstin logjik të rregullimit ligjor, duke e konsideruar pa peshë këtë gabim material, pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit, për *mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 98 m² dhe garazh me sipërfaqe 25 m² në Vlorë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016*, është i drejtë dhe i bazuar. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e kësaj pasurie, për sa i përket pagesës së këstit të dytë dhe të tretë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, sipas arsyetimit të trupit gjykues në vijim.

16.1. Së pari, në deklaratat periodike të pasurisë, të ardhurat e deklaruara nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë, subjekti i përdor si burim për krijimin e pasurisë apartament dhe garazh, në Vlorë. Konkretisht, me pjesë takuese 50%, subjekti deklaroi në DIPP-në 2008, shtuar 3.200.000 lekë (26.000 euro) të përfituara si kapar nga premtimi për shitje apartament banimi në Gjirokastrë, pakësuar shuma e mësipërme 26.000 euro, pasi është paguar si kapar në kontratën paraprake të shitblerjes apartament + garazh. Në DIPP-në 2009, shtuar 3.000.000 lekë nga shitja e apartamentit të banimit + pasuri e luajtshme në Gjirokastrë, pakësuar shuma e mësipërme me 2.600.000 lekë për pagesë në bazë të kontratës paraprake të shitblerjes të 2 apartamenteve banimi 1+1 dhe garazh, në Vlorë. Në DIPP-në 2010, shitur apartament banimi 2 + 1, me sip. 104 m², lagjja “{***}”, Gjirokastrë. Shuma e përfituar është deklaruar në vitet 2009-2010. Në DIPP-në 2011, shtuar 2 apartamente banimi 1 + 1 (një banesë) + garazh blerë me kontratën përfundimtare të shitjes me nr. {***} rep., datë 07.01.2011, çmimi i blerjes deklaruar më parë, vlera 6.500.000 lekë = 51.000 euro, deklaruar më parë.

16.2. Nga aktet në fashikuj, rezulton se mes subjektit, në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “{***}” ShPK e shtetasit Sh. L., në cilësinë e të porositurve/investitorëve, në datën 30.12.2008, është lidhur *kontratë paraprake e shitblerjes të sendit të ardhshëm*¹⁷, dy apartamente [1+1, me sip. banimi 55 m² dhe 44 m²] dhe një garazh me sipërfaqe 25 m². Vlera totale prej 50.300 eurosh parashikohet të likuidohet në katër këste: i pari 26.000 euro, paguar në ditën e nënshkrimit të kontratës; i dyti 10.000 euro deri në datën 30.03.2009; i treti 10.000 euro deri në datën 30.06.2009; dhe i katërti 4.300 euro deri në datën 30.08.2009. Në kontratë parashikohen penalitete: për porositësin për vonesa për kryerjen e pagesave, për shoqërinë ndërtuese për vonesë në dorëzimin e apartamenteve. Në datën 07.01.2011, palët lidhin kontratat e shitjes¹⁸ për pasuritë: apartament me sip. 54 m², me çmim shitje 3.000.000 lekë; apartament me sip. 44 m², me çmim shitje 2.500.000 lekë; si dhe garazh me sip. 25 m², me çmim shitje 1.000.000 lekë. Në këto kontrata, citohet se çmimi është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale. Nga informacioni i ZVRPP-së Vlorë, rezulton se është bërë bashkimi i dy apartamenteve qysh në ndërtim e në datën 24.01.2014 është bërë regjistrimi i tyre pranë ZVRPP-së Vlorë si një pasuri e vetme, me sipërfaqe totale 98 m² dhe nr. pasurie {***}.

16.3. Lidhur me të ardhurat nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë, nga aktet në fashikuj rezulton si vijon. Në datën 09.12.2008, subjekti dhe bashkëshortja M. S. [kaparmarrës] dhe shtetasi P. Ll. [kapardhënës] nënshkruajnë “kontratë kapari”¹⁹, ku deklarohet marrja e shumës prej 3.200.000 lekësh, që përbën një pjesë të çmimit të shitjes së një apartamenti banimi me sip. 104.9 m², lagjja “{***}”, Gjirokastrë²⁰, se çmimi i shitjes do të jetë 6.200.000 lekë dhe pjesa e mbetur e tij do të likuidohet nga kapardhënësi menjëherë pasi të përfitojë kredinë për të cilën ka aplikuar në

¹⁷ Kontratë paraprake nr. {***}, datë 30.12.2008, notere L. C.

¹⁸ Kontrata shitje me nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, respektivisht për apartamentet me numër pasurie {***} dhe numër pasurie {***}, si dhe garazh me numër pasurie nr. {***}.

¹⁹ Kontratë kapari me nr. {***}, datë 09.12.2008, notere F. Sh.

²⁰ Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor me datë lëshimi 25.12.2008, ZVRPP, rrethi Gjirokastrë, pasuri e regjistruar me nr. {***}.

Bankën Popullore, dega Gjirokastrë. Në kontratë pasqyrohet se pasuria është marrë në dorëzim nga blerësi kapardhënës, i cili bëhet pronar i ligjshëm, pasi të likuidohet pjesa tjetër e çmimit të shitjes dhe të legalizohet kontrata e shitjes në zyrën e noterisë, brenda një afati prej dy muajsh. Palët bien dakord se nëse pas mbarimit të afatit nuk bëhet kalimi i pronësisë, kthehen në gjendjen e mëparshme, kaparmarrësi detyrohet të kthejë shumën prej 3.200.000 lekësh dhe kapardhënësi të dorëzojë pasurinë *objekti i kontratës*. Në datën 10.01.2009, palët nënshkruajnë kontratën e shitjes për pasurinë apartament me sipërfaqe 104,9 m², në Gjirokastrë, ku çmimi i shitjes pasqyrohet në vlerën 4.479.230 lekë, çmimi për metër katror 42.700 lekë/m², si dhe deklarohet se është likuiduar tërësisht²¹. Rezulton se në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit, shtetasi P. Ll. ka transferuar këstin/kaparin prej 3.200.000 lekësh në ditën e nënshkrimit të kontratës së kaparit, datë 09.12.2008 dhe më 14.01.2009, katër ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitjes së pasurisë, ka transferuar shumën prej 3.000.000 lekësh, pjesa e pashlyer e çmimit sipas kontratës së kaparit. Në vijim, në datën 30.12.2009, subjekti depoziton në BKT shumën prej 273.123 lekësh, me përshkrimin “*Albert Spiro derdh tatim shitje, sipas kontratës nr. {***}, datë 10.01.2009*”.

16.4. Subjekti pretendoi se me dakodësinë e palëve dhe sugjerimin e noteres, kontrata e shitjes së apartamentit në Gjirokastrë u hartua me çmimin e referencës së shitjes të pasurisë të paluajtshme të zonës, duke mos pasur të pasqyruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme koston e ndërtimit të objektit. Sipas tij, meqë në kontratën e EKB-së, me të cilën ishte fituar kjo pasuri, nuk kishte të përcaktuara të dhëna si kosto ndërtimi, sipërfaqe etj., palët e përfshira u ndeshën me vështirësi në përcaktimin e koston së ndërtimit, si element për llogaritjen e tatimit dhe ZVRPP-ja Gjirokastrë ka llogaritur tatimin mbi vlerën e përcaktuar në kontratën e kaparit prej 6.200.000 lekësh dhe i ka konsideruar vlerë të arredimit vetëm 430.000 lekë. Subjekti shpjegon se gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se vlera e arredimit është rreth 1.000.000 lekë dhe jo sa është llogaritur nga ZVRPP-ja, pra, ka paguar në mënyrë jo të saktë edhe për vlerën e mobilimit. Vlera e parashikuar në kontratë, për të cilën Komisioni ka konstatuar se janë paguar detyrimet tatimore, i përket shitjes së pasurisë së paluajtshme, ndërsa për sendeve të luajtshme [mobilim dhe pajisje elektroshtëpiake] të lidhura ngushtë me apartamentin, legjislacioni nuk parashikon formë ligjore për shitjen e tyre dhe as për detyrime tatimore.

16.5. Trupi gjykues, *së pari*, konstaton se çmimi i apartamentit në kontratën e shitjes i korrespondon çmimit të shitjes së ndërtesave për qytetin e Gjirokastrës për efekt fiskal, parashikuar në tabelën 3 të Udhëzimit nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”. Pasqyrimi në kontratë i këtij çmimi dhe jo të një çmimi nën të ishte detyrim i noterit, në të kundërt konsiderohej kundërvajtje administrative dhe penalizohej zyra e noterisë²². Fakti që

²¹ Me shkresën nr. {***}, datë 15.04.2019, AShK Gjirokastrë ka përcjellë praktikën e shitjes së pasurisë, ku është pjesë dhe kontrata e shitjes së apartamentit me nr. {***}, datë 10.01.2009, notere F. Sh.

²² Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së Pasurisë së paluajtshme”, parashikon: [...] 11. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për njohjen zyrtare të zyrave noteriale me këtë udhëzim, lidhur me respektimin e zbatimit të çmimeve minimale fiskale të përcaktuara. Mosrespektimi i çmimeve në kontratat e noterizuara të shitjeve të pasurisë së paluajtshme konsiderohen kundërvajtje administrative për zyrat e noterisë dhe penalizohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. [...].

apartamenti nuk kishte të pasqyruar vlerë në regjistrat e pasurisë, nuk mund të pretendohet si shkak për të kushtëzuar caktimin e çmimit në kontratën e shitjes së tij. Për më tepër, rezultoi se palët e kanë nënshkruar kontratën e shitjes disa ditë pasi shuma prej 6.200.000 lekësh ishte transferuar nga blerësi në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit, sipas çmimit të përcaktuar në kontratën e kaparit, objekti i së cilës ishte vetëm shitja e apartamentit. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, në kontratën e shitjes të nënshkruar me vullnet të lirë nga palët, përcaktimi i çmimit në nivelin minimal për efekt fiskal duket në favor të interesit të shitësit/subjektit, për sa është një nga elementët përcaktues për llogaritjen e tatimit mbi fitimin. *Së dyti*, udhëzimi i sipërcituar rregullon edhe përcaktimin e një vlere minimale për efekt të caktimit të tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë, për ndërtesat e ndërtuara dhe të regjistruara pas datës 1 janar 1996, pa vlerë në blerje²³. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, pretendimi i subjektit se kosto mesatare²⁴ për 1/m² të sipërfaqes së shfrytëzueshme është 28.967 lekë/m², përkundrajt 27.704 lekë/m² të llogaritur prej Komisionit, vlerësohet i pabazuar, për sa për efekt fiskal procedura ligjore parashikon vlerën në kohën e ndërtimit të ndërtesës.

16.6. Subjekti pretendoi se shlyerja e detyrimit tatimor, rreth 12 muaj më vonë, pa penalitet, i cili do të aplikohet në rast se vonesa në shlyerje do të shkaktohet prej tij, konfirmon vështirësitë/paqartësitë e ZVRPP-së për llogaritjen e vlerës së apartamentit. Trupi gjykues vlerëson se përpos faktit se për efekt fiskal mungesa e vlerës së ndërtesave në transaksion ishte rregulluar me Udhëzimin sipërcituar e, për rrjedhojë, pretendimet për vështirësi të ZVRPP-së janë të pabazuara, referuar kuadrin ligjor të kohës, nenet 11 dhe 12 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”²⁵, neni 11 i ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”²⁶ dhe Udhëzimi nr. 9/2008, parashikohen penalitete vetëm për paraqitje tej afatit ligjor

²³ Udhëzimi nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar, në pikën 6.2, parashikon: [...] Për ndërtesat e ndërtuara dhe të regjistruara pas datës 1 janar 1996 e në vitet në vijim, të cilat nuk kanë vlerë në blerje, për efekt të përcaktimit të tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë, si vlerë minimale në blerje, do të merret kosto mesatare për 1/m² të sipërfaqes së shfrytëzueshme e përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave në: vendimet e Këshillit të Ministrave: VKM nr. 815, datë 09.12.1996; VKM nr. 13, datë 05.01.1998; VKM nr. 214, datë 28.04.1999; VKM nr. 362, datë 14.07.2000; udhëzimet e Kryeministrit nr. 5, datë 31.05.2001 dhe nr. 3, datë 16.10.2002; në udhëzimin e Kryeministrit nr. 1, datë 8.5.2003; nr.1, datë 04.03.2004; nr. 5, datë 23.11.2005; nr. 5 datë 07.09.2006 dhe nr. 2, datë 04.04.2007 dhe udhëzimin e Kryeministrit nr. 1, datë 20.08.2008, udhëzimin e Kryeministrit nr. 2, datë 05.11.2008, të cilat janë pasqyruar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, si dhe në aktet e tjera për vitet në vijim. [...].

²⁴ Udhëzimi i Kryeministrit nr. 1, datë 08.05.2003, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit K”.

²⁵ Ligji nr. 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, parashikon:

- Neni 11 “Regjistrimi i detyruar”: “Çdo kontratë apo dokument tjetër që ka efekt mbi të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme paraqiten për regjistrim jo më vonë se tridhjetë ditë nga koha e realizimit të tij”.
- Neni 12 “Vonesa në regjistrim”: “Nëse një dokument paraqitet për regjistrim më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë, që ka kaluar nga kjo datë, paguhet kamatëvonesë e barabartë me 10 për qind të tarifës së regjistrimit”.

²⁶ Ligji nr. 8438, në nenin 11 të titulluar “Kalimi i të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, parashikon: “[...] 2. Tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. 3. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që, brenda datës 20 të muajit pasardhës, të transferojnë për llogari të administratës

30-ditor të dokumentit për regjistrim. Sipas akteve të sipërcituara, pa provuar shlyerjen e detyrimit tatimor, nuk regjistrohej kalimi i titullit të pronësisë. Në kontekst të parashikimeve ligjore të kohës, në kontratën e shitjes pasqyrohen detyrimet e palëve pas nënshkrimit të saj, konkretisht blerësi duhet të paraqitet *pranë ZVRPP-së brenda një muaji nga redaktimi i kontratës, në të kundërt do të paguajë një tarifë shtesë prej 10% të tarifës së regjistruar për çdo ditë vonesë*; ndërsa për shitësit [subjekti dhe bashkëshortja], pasqyrohet se *morën dijeni për pagimin e % të çmimit të shitjes në ZVRPP-në Gjirokastrë, sipas Udhëzimit nr. 9, datë 26.02.2008, me qëllim që blerësit t'i lindë e drejta e regjistrimit të pasurisë*. Në këto kushte, pretendimi i subjektit se mospagimi prej tij i ndonjë penalteti, që në kuptim të ligjit nuk mund t'i ngarkohej atij, provon vështirësitë e ZVRPP-së për përcaktimin e tatimit dhe i jep besueshmëri versionit të ngritur prej tij në mbrojtje, konsiderohet pa relevancë në këtë kontekst.

16.7. Lidhur me pretendimin e subjektit se sipas akteve të kohës, të cilat aplikoheshin prej ZVRPP-së Gjirokastrë, kjo e fundit ka llogaritur vlerën e tatimit për kalimin e së drejtës së pasurisë së paluajtshme për totalin e shumës së përfituar prej 6.200.000 lekësh, të përcaktuar në kontratën e kaparit dhe ka konsideruar vlerë të arredimit 430.000 lekë, provuar edhe nga shuma e paguar si detyrim tatimor prej 273.123 lekësh, trupi gjykues, përpos të pakuptimtë, e vlerëson të pabazuar për sa vijon. *Së pari*, referuar kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, si edhe parashikimeve të Udhëzimit nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”²⁷, nuk rezulton asnjë shkak ligjor që ZVRPP-ja Gjirokastrë, edhe në rolin e agjentit tatimor, të administronte një dokument tjetër përpos kontratës së shitjes së pasurisë dhe të mos i referohej çmimit të shitjes së pasurisë të përcaktuar në të, për më tepër në kushtet që çmimi i apartamentit në kontratën e shitjes rezultonte si çmimi minimal për efekt fiskal. *Së dyti*, nga aktet në fashikuj nuk rezulton asnjë e dhënë se për kalimin e titullit të pronësisë nga subjekti te blerësi P. Ll., në ZVRPP të jetë paraqitur apo të jetë referuar kontrata e kaparit. Konkretisht, rezulton se në datën 10.02.2009 blerësi P. Ll. ka aplikuar pranë ZVRPP-së Gjirokastrë për regjistrimin e kontratës së shitjes nr. {***}, datë 10.01.2009; në mandatin bankar për shlyerjen e detyrimit tatimor, lëshuar në emër të Albert Spiros pasqyrohet shlyerja e tatimit sipas kontratës nr. {***}, datë 10.01.2009; AShK-ja Gjirokastrë ka informuar se në dokumentacionin tekniko-ligjor të regjistrimit të kontratës së shitjes nr. {***}, datë 10.01.2009, nuk rezulton formular për llogaritje

tatimore tatimin e paguar, sipas parashikimeve të këtij neni. 4. Ministri përgjegjës për financat dhe ministri apo institucioni që ka në fushën e përgjegjësisë regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përcaktojnë me udhëzim të përbashkët kushtet, procedurat dhe metodologjinë për zbatimin e këtij neni”.

²⁷ Udhëzimi nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, parashikon: “Me kalim të së drejtës së pronësisë, kuptohet akti i shitjes apo akti i dhurimit të pasurisë së paluajtshme. Në kuptim të nenit 11 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, me termin “fitim kapital i realizuar” kuptohet diferenca ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë ndërtesë apo tokë [...]. 4. Vlera në shitje e pasurisë së paluajtshme, përcaktohet në kontratën e noterizuar të shitjes, e cila është firmosur nga palët (shitësi dhe blerësi). Mosrespektimi i çmimeve në kontratat e noterizuara të shitjeve të pasurisë së paluajtshme konsiderohen kundërvajtje administrative për zyrat e noterisë dhe penalizohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. 5. Në rastet kur çmimi i shitjes për m² i përcaktuar në kontratë është më i ulët se çmimi minimal i përcaktuar në shtojcat nr. 2 dhe nr. 3 bashkëngjitur udhëzimit, zbatohen këto të fundit për efekt të llogaritjes së tatimit”.

të tatimit të kalimit të pronësisë që i përket shumës së arkëtuar. Sa më sipër, pretendimet e subjektit mbeten deklarative dhe të paprovuara.

16.8. Subjekti pretendoi se shuma prej 6.200.000 lekësh është përfituar nga shitja e apartamentit (*pasuri e paluajtshme*) dhe e arredimit të tij (*pasuri e luajtshme*) dhe se vlera e përcaktuar në kontratën e shitjes i përket pasurisë së paluajtshme, si forma më e mirë për shmangien e keqkuptimeve dhe të aplikimit të tatimit mbi shitjen e pasurive të luajtshme. Gjithashtu, subjekti pretendoi se në kontratën e kaparit nuk i ka kushtuar shumë vëmendje përshkrimin të pronës dhe sendeve të shitura me të, për sa qëllimi i kontratës ishte sigurimi për dhënien e parave deri në momentin e kontratës së shitjes. Lidhur me këtë pretendim, nga aktet në fashikuj, konstatohet dhe analizohet si vijon.

16.9. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, lidhur me burimet e krijimit të pasurive apartament dhe garazh në Vlorë, subjekti deklaroi *shumën 6.200.000 lekë nga shitja e apartamentit në Gjirokastër* dhe si dokumentacion justifikues ligjor ka depozituar kontratën e kaparit. Referuar kontratës së kaparit, objekti i së cilës është vetëm shitja e apartamentit me sipërfaqe 104 m² me çmim 6.200.000 lekë, i cili është marrë në dorëzim nga blerësi kapardhënës dhe në rast të mospërmbushjes së detyrimeve brenda afatit 2-mujor, pagimit të pjesës së mbetur të çmimit prej kapardhënësit, palët kthehen në gjendjen e mëparshme: kapardhënësi është i detyruar të dorëzojë pasurinë *objekt kontrate-apartamentin* dhe kaparmarrësi/subjekti është i detyruar të kthejë kaparin, shumën prej 3.200.000 lekësh. Për rrjedhojë, për sa përmes parashikimeve në kontratë, palët kanë marrë garanci edhe për kthimin në gjendjen e mëparshme, nuk duket bindëse lënia jashtë vëmendjes e pasurisë së luajtshme, në rast se ajo do të ishte shitur bashkë me apartamentin. Në të kundërt, në interes të palëve në kontratë, kapardhënësit/blerësit që do të paguante për to dhe kaparmarrësit/shitësit, për të marrë garancitë në rast të kthimit të tyre, do të duhej të përfshihej në objektin e kontratës së kaparit pasuria e luajtshme e inventarizuar dhe me vlerë të përcaktuar. Për më tepër, subjekti është kontradiktor lidhur me vlerën e saj, duke e deklaruar 1.000.000 lekë gjatë hetimit administrativ e njëherazi të llogaritur në vlerën 430.000 lekë nga ZVRPP-ja.

16.10. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit për shitjen e pasurisë së luajtshme, arredimit të apartamentit, nuk provohen as nga deklaratat e tij në deklaratat vjetore të pasurisë. Konkretisht: në DIPP-në 2008, të dorëzuar në mars të vitit 2009, pasi ishte formalizuar kontrata e shitjes më 10.01.2009, deklaroi të ardhura prej 3.200.000 lekësh (26.000 euro), të përfituara si *kapar nga premtimi për shitje apartament banimi*; në DIPP-në 2009 deklaroi të ardhura prej 3.000.000 lekësh nga shitja e apartamentit të banimit + pasuri e luajtshme në Gjirokastër; dhe në DIPP-në 2010, deklaroi shitjen e apartamentit me sipërfaqe 104 m², në Gjirokastër, pa vlerë, dhe se shuma e përfituar është deklaruar në vitet 2009 dhe 2010. Në rast se të ardhurat e deklaruara do të ishin përfituar edhe nga shitja e pasurisë së luajtshme, subjekti do të kishte dëshmuar konsistencë duke mos e përjashtuar shitjen e pasurisë së luajtshme në asnjë prej deklaratimeve të tij. Për më tepër, nën përgjegjësinë e buruar nga ligji nr. 9049/2003 dhe qartësisht në tekst të deklaratës për *deklarim të shtesës/pakësimit të pasurive të bazuar në dokumentacion*,

edhe deklarimi në DIPP-në 2009 + *plus pasuri e luajtshme*, për të cilën nuk deklarohet vlerë, nuk provon për të ardhura nga shitja e të gjithë arredimit të apartamentit. Ky deklarim duket të bëhet në funksion të kontrollit të ILDKPKI-së, sipas nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003, për sa kontrata e shitjes së apartamentit nxirrte në pah deklarimin/përfitimim e një shume prej 1.720.770 lekësh më shumë nga çmimi i përcaktuar në të.

16.11. Nga aktet në fashikuj, konstatohet se në vitin 2015 subjekti ka dhënë shpjegime në ILDKPKI, lidhur me pasaktësi të konstatuara nga ky institucion në deklaratat e pasurisë 2003-2013²⁸. Ndër të tjera, subjektit i është kërkuar të paraqesë dokumentacion lidhur me deklarimin në DIPP-në 2008 *premtim shitje për apartamentin në Gjirokastër*. Subjekti ka paraqitur kontratën e kaparit dhe në shpjegimet e dhëna, të pasqyruara në dy procesverbale, po ashtu, edhe në materialin dorëzuar prej tij për këtë qëllim, nuk ka pretenduar se çmimi i shitjes ka përfshirë edhe pasurinë e luajtshme. Për pasaktësi të tjera të konstatuara nga ILDKPKI-ja, konkretisht, lidhur me mosdeklarimin në DIPP-në 2009 të gjendjes së depozitës bankare në BKT në emër të bashkëshortes, ku blerësi ka kaluar të gjithë shumën prej 6.200.000 lekësh, subjekti ka shpjeguar se: [...] *Në vitin 2009 janë bërë lëvizje bankare të kësaj llogarie edhe për faktin e blerjes së apartamentit në Vlorë. Siç kam deklaruar, për krijimin e pasurisë së paluajtshme në Vlorë ka shërbyer shitja e apartamentit në Gjirokastër*. Për rrjedhojë, edhe në këtë rast, shpjegimet e subjektit nuk provojnë sa pretenduar prej tij, shitjen e apartamentit së bashku me mobilimin dhe pajisjet elektroshtëpiake.

16.12. Subjekti pretendoi se shitja e mobilimit dhe pajisjeve elektroshtëpiake të apartamentit në Gjirokastër dëshmohej edhe nga deklarimi i tij për shpenzime mobilimi për apartamentin në Vlorë në vitet 2009-2010. Trupi gjykues e vlerëson pa peshë këtë argument, për të konkluduar se apartamenti në Gjirokastër është shitur bashkë me mobilimin ose së paku mobilimi i tij ka pasur një vlerë të shtuar në atë të apartamentit në mënyrë të posaçme. Subjekti mund të ketë lënë në dispozicion të blerësve mobilimin e bërë në apartamentin e shitur, siç mund të ketë marrë prej tij një pjesë për t'u përdorur tek apartamenti i blerë në Vlorë, sipas sugjerimit që jo gjithë shpenzimi i deklaruar për mobilim, në vlerën prej 650.000 lekësh, ka qenë i mjaftueshëm për ta bërë të banueshëm një apartament të ri. Të gjithë këto argumente dhe kundërgargumente nuk janë të mjaftueshme për të provuar pretendimet e subjektit, në kushtet kur në kontratën e shitjes së pasurisë, si dokument zyrtar në të cilin përshkruhen sendet objekt të veprimit juridik, nuk ka asnjë parashikim për sende të luajtshme siç pretendon subjekti.

16.13. Në jurisprudencën e tij, Kolegji ka shtjelluar se saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi apo në përdorim të tij dhe të personave të lidhur, janë elemente përcaktuese për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë, në plotësimin e kërkesave të normave kushtetuese

²⁸ *Me shkresën nr. {***} prot., datë 23.04.2024, ILDKPKI-ja ka dërguar, sipas kërkesës së Komisionit procesverbalet dhe dokumentacionin bashkëlidhur. Konkretisht, janë përcjellë, procesverbale "Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive" të datave 20.03.2015 dhe 16.04.2015 (me të njëjtat pyetje), sqarime me shkrim nga subjekti (të cilat janë pasqyruar edhe në procesverbal) dhe dokumentacionin e dorëzuar prej tij.*

dhe ligjore të posaçme për rivlerësimin kalimtar të subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi²⁹. Subjekti, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur deklaratën noteriale të blerësit P. Ll.³⁰, i cili deklaron se apartamentin e ka blerë së bashku me sendet e luajtshme (mobilimin) dhe të gjitha pajisjet elektroshtëpiake. Trupi gjykues, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit në jurisprudencën e tij, edhe në këtë rast e vlerëson këtë deklaratë noteriale si provë të njëanshme, që synon të mbështesë pretendimet e subjektit. Në përfundim të shqyrtimit të të gjithë argumenteve të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit se shuma për të cilën nuk janë paguar detyrimet tatimore i përket vlerës së pasurisë së luajtshme, në të gjithë këndvështrimet, mbeten deklarative dhe të pambështetura në aktet e administruara në fashikuj.

16.14. Lidhur me këstin të dytë në vlerën 2.600.000 lekë, subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit, se ai dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të mjaftueshme në vlerën 272.953 lekë, duke pretenduar se: (i) për sa ka provuar ligjshmërinë e shumës 6.200.000 lekë, të përfituar nga shitja e apartamentit në Gjirokastër dhe pasurisë së luajtshme, ka provuar ligjshmërinë e shumave me këtë burim, prej 1.935.000 lekësh, të paguar në rrugë bankare dhe prej 500.000 lekësh të tërhequr *cash* nga llogaria bankare e bashkëshortes e të paguar në fund të vitit 2009; (ii) për pjesën e mbetur të këstit, shumën prej 165.000 lekësh, të deklaruar me burim krijimi kursimet e deri atëhershme vjetore nga të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, ka pasur mundësi për krijimin e këtyre kursimeve, duke vlerësuar se për arredimin e apartamentit në vitin 2009 ka shpenzuar 95.000 lekë më pak se vlera e llogaritur prej Komisionit se ka pakësuar gjendjen e kursimeve *cash* në vlerën 100.000 lekë, si dhe duke llogaritur shpenzimet për jetesë 466.752 lekë sipas ILDKPKI-së dhe jo 546.480 lekë sa janë llogaritur nga Komisioni.

16.15. Nga lëvizjet e llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit, ku është kaluar shuma e shitjes së apartamentit prej 6.200.000 lekësh, konstatohet se në favor të përfaqësuesit të firmës ndërtuese “{***}” ShPK, janë transferuar: në datën 15.12.2008, shuma 3.200.000 lekë, kësti i parë i pagesës dhe në datën 17.04.2009, shuma 1.935.000 lekë. Shuma e mbetur në llogari pas këtyre transfertave është kaluar në depozitë me afat dhe pas maturimit në datën 28.12.2009 është tërhequr vlera prej 500.000 lekësh dhe shuma e mbetur prej 588.795 lekësh është kaluar në depozitë bankare. Nga të ardhurat e ligjshme nga shitja e apartamentit në Gjirokastër prej 5.636.382 lekësh, duke zbritur pagesën për këstin e parë prej 3.200.000 lekësh, shuma e mbetur prej 2.436.382 lekësh është pothuaj sa shuma 2.435.000 lekë [1.935.000 (transfertë) + 500.000 (*cash*)] e deklaruar prej subjektit me këtë burim për pagesën e këstit të dytë prej 2.600.000 lekësh.

16.16. Lidhur me pjesën e mbetur të këstit të dytë prej 165.000 lekësh, të deklaruar me burim kursimet e deri atëhershme vjetore të të ardhurave nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, subjekti pretendon se në mënyrë të pabazuar nuk është konsideruar pakësimi i gjendjes *cash* në vitin 2009,

²⁹ Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit nr. 5/2019 (JR), nr. 6/2019 (JR), nr. 9/2019(JR), nr. 13/2019(JR) dhe nr. 19/2019 (JR).

³⁰ Deklaratë noteriale me nr. {***}, datë 21.06.2021.

përdorur për arredimin e apartamentit në Vlorë dhe se shpenzimet e jetesës nuk janë llogaritur për rajonin bregdetar, sipas të dhënave të INSTAT-it. Sipas subjektit, duke konsideruar të ardhurat vjetore siç i ka paraqitur dhe me pakësimin e gjendjes së kursimeve *cash* 100.000 lekë diferencën në shpenzimet e arredimit 95.000 lekë dhe diferencën në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, justifikohet plotësisht mungesa e burimeve të mjaftueshme në vlerën 272.953 lekë.

16.17. Subjekti pretendoi se shpenzimet e arredimit për vitin 2009 janë llogaritur 325.000 lekë, përkundërt deklarimeve të tij se kanë qenë në shumën 230.000 lekë dhe 100.000 lekë nga pakësimi i gjendjes *cash*. Sipas subjektit, arsyetimi i Komisionit, për shpërndarje të shpenzimeve të arredimit në funksion të rezultatit të analizës financiare, është në kundërshtim me ligjin, pasi Komisioni duhet ta provojë dhe jo nëpërmjet hamendësimit të pranojë si të vërtetë një fakt që nuk është i tillë. Nga aktet në fashikuj, trupi gjykues, *së pari*, konstaton mungesë konsistence në deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ lidhur me shpenzimet për arredim. Subjekti fillimisht ka deklaruar se nuk mban mend sa është shpenzuar për arredim në secilin prej viteve 2009 dhe 2010³¹ dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ku në analizën financiare vlera e arredimit të apartamentit 650.000 lekë është ndarë barazisht në vitet 2009 dhe 2010 [325.000 lekë/vit], sikundër në ankim, ka pretenduar rishpërndarjen e tyre, sipas pasqyrimin në raportin e audituesit, paraqitur si provë prej tij. *Së dyti*, në DIPP-në 2009, subjekti deklaroi *shtesë kursime nga pagat, depozitë dhe cash. Vlera 300.000 lekë dhe 100.000 lekë depozitë Alpha Bank. Shtesë nga interesat bankare në Alpha Bank dhe BKT 100.000 lekë.* Përpos se në DIPP-në 2009 subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*, ndërkohë që ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5, parashikon në mënyrë të posaçme vlerën provuese të deklaratave periodike të interesave në procesin e rivlerësimit, pretendimi për të “transferuar” shpenzimet për arredim në gjendjen *cash* të pretenduar të bartur nga viti 2008 mbetet deklarative dhe duket se tregon përpjekje për të rregulluar ekuilibrat financiarë të vitit 2009 dhe të viteve pranë. *Së treti*, në procesverbalin e ILDKPKI-së të vitit 2015, i cili do të analizohet gjerësisht në vijim, në përgjigje të pyetjes lidhur me *mosbulim në vitin 2011 me të ardhura neto të aseteve neto në shumën 997.800 lekë*, subjekti shpjegon pakësim të gjendjes *cash* 700.000 lekë dhe 3.000 euro, respektivisht për pagesën e kështit të tretë të apartamentit në Vlorë dhe të pasurisë garazh në {***}, Tiranë. Në ankim, sikundër edhe gjatë procesit administrativ në Komision, subjekti pretendon se deklarimi në procesverbalin e ILDKPKI-së në vitin 2015 i gjendjes *cash* në vlerën 1.000.000 lekë në fund të vitit 2010, tregon se 200.000 lekë janë përdorur për arredimin e apartamentit në Vlorë në vitet 2009-2010, në të kundërt, sipas DIPP-ve, gjendja e likuiditeteve *cash* për periudhën 2003-2010 duhet të ishte 1.200.000 lekë. Në këtë situatë faktike, në vitin 2015, shpjegimet e subjektit, për burimin e shumave të shpenzuara në vitin 2011 për krijimin e pasurive, jo vetëm duket se janë të sforcuara, për të zgjidhur problematikat lidhur me burimet e krijimit të pasurive, aq më pak mund të provojnë

³¹ Në përgjigje të pyetjes nr. 14 të pyetësorit standard, subjekti deklaroi: “Shpenzimet për mobilimin e banesës në Vlorë kanë qenë rreth 650.000 lekë. Mobilimi, dhomat e gjumit, kuzhina etj. është bërë nga shoqëria “{***}” në shumën rreth 280.000 lekë dhe këndi dhe trapezaria janë blerë tek “{***}”, për shumën rreth 120.000 lekë. Pjesa tjetër është përdorur për blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake. Mobilimi është bërë gjatë viteve 2009-2010 periudhë në të cilën janë bërë dhe pagesat, por saktësisht nuk i mbaj mend”.

pretendimin për pakësimin e gjendjes *cash* të vitit 2008. Për më tepër, edhe në kontekst të ndreqjes së pasaktësive, nuk rezulton që subjekti në këtë procesverbal të ketë deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në vitet përpara 2011. Për sa më sipër, argumentet e parashtruara prej subjektit, për mbulim të shpenzimeve të arredimit të apartamentit në Vlorë nëpërmjet pakësimit të gjendjes *cash*, mbeten deklarative, të paprovuara dhe vlerësohen nga trupi gjykues si përpjekje për të ndikuar në rezultatin e analizës financiare të vitit 2009, e cila edhe në rast të konsiderimit të pretendimit të subjektit sërish do të rezultonte me balancë negative.

16.18. Për sa i përket pretendimit se shpenzimet e jetesës nuk janë llogaritur sipas të dhënave të INSTAT-it, të specifikuara për secilin rajon, trupi gjykues vlerëson se ai është i pabazuar për sa vijon. *Së pari*, në raportin e audituesit ligjor A. M., të paraqitur nga subjekti si provë, citohet shkresa nr. {***} prot., datë 24.05.2011, e INSTAT-it dërguar ILDKPKI-së, ku përcaktohet konsumi mesatar mujor dhe vjetor në familje dhe për frymë për vitin 2008, pa specifikuar qytet apo rajon. *Së dyti*, organet e rivlerësimit kanë një praktikë të konsoliduar sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të jetesës, bazuar në të dhëna zyrtare, që i referohen një mesatare të përgjithshme, përfshirë edhe nivelin e varfërisë, e cila përfaqëson një standard garantist dhe dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit, përmes së cilave synohet reduktim i shpenzimeve të jetesës, vlerësohen të pabazuara e, për rrjedhojë, të papranueshme.

16.19. Lidhur me këstin prej 700.000 lekësh, subjekti kundërshton si të pabazuar konkluzionet e Komisionit për deklarim të pasaktë dhe mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 700.000 lekë, me pretendimin se referuar DIPP-ve të periudhës 2008-2011 kuptohet lehtë ky detyrim ndaj shoqërisë ndërtuese dhe shlyerja e tij me pakësimin të gjendjes *cash* deklaruar prej tij në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në vitin 2015 përbën provë të plotë, edhe sipas qëndrimit të mbajtur nga Komisioni dhe Kolegji³². Subjekti potencon se për gjendjen e kursimeve *cash* ka përputhje të shifrave deri në deklaratën *vetting*, ku vlera e deklaruar në deklaratën *vetting* prej 300.000 lekësh rezulton saktësisht duke i zbritur vlerës së kursimeve *cash* të vitit 2011 vlerën prej 700.000 lekësh të shlyerjes së këstit të tretë të apartamentit.

16.20. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, të cilat në thelb kanë *mungesë të trajnimit për plotësimin e deklaratës së pasurisë e, për pasojë, keqinterpretim të rubrikave të saj, harresa nga mosdhënia e rëndësisë sa duhej apo pakujdesi në momentin e plotësimit të tyre, vlerësimin e procesverbalit të ILDKPKI-së në raport me provat e tjera dhe situatën faktike*, si dhe të akteve në fashikuj, vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i bazuar sipas arsytimit në vijim.

16.20.1. Lidhur me mosdeklarimin e detyrimit ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, në DIPP-të e periudhës 2008-2010, subjekti parashtron se: (i) nuk ka pasur qëllim fshehjen e tij, për sa ka deklaruar detyrimin e kontratës së blerjes dhe vlerat e shlyera çdo vit, prej nga kuptohet vlera e

³² Subjekti referon vendimet e Kolegjit nr. 12/2018 (JR); nr. 10/2018 (JR), që i përket subjektit G. T., pika 14. Gjithashtu, referon vendime të Komisionit nr. 368/2021, pika 81.4 që i përket subjektit K. H.; nr. 280/2021, që i përket subjektit M. Z., pika 7.15.

detyrimin të mbetur ndaj shoqërisë; (ii) deklarimi në DIPP-në 2011 *shtuar dy apartamente banimi 1+1 (një banesë) = garazh blerë më kontratën përfundimtare të shitjes datë 07.11.2011, çmimi i blerjes deklaruar më parë, vlera 6.500.000 lekë = 51.000 euro*, nënkupton se detyrimet në këtë datë janë shlyer.

16.20.2. Trupi gjykues konstaton, *së pari*, se në DIPP-në e vitit 2008, vit kur është nënshkruar kontrata paraprake e shitblerjes së pasurive dhe as në DIPP-të e viteve vijuese subjekti nuk ka deklaruar çmimin e pasurive, kushtet kontraktuale për likuidimin e tij dhe as detyrimin ndaj firmës ndërtuese. Në DIPP-të 2008 dhe 2009, subjekti deklaroi vetëm shumën e shlyera, konkretisht: në DIPP-në 2008 *pagesë si kapar në kontratën paraprake të shitblerjes apartament+garazh, vlera 26.000 euro [3.200.000 lekë]*; në DIPP-në 2009 *pagesë në kontratën paraprake të shitblerjes 2 apartamente 1+1 +garazh, vlera 2.600.000 lekë*; në DIPP-në 2010 nuk bën asnjë deklaram; dhe në DIPP-në 2011 deklaroi *shtuar dy apartamente banimi 1+1 (një banesë) + garazh blerë me kontratën përfundimtare të shitjes datë 07.01.2011 me nr. {***} rep., çmimi i blerjes deklaruar më parë, vlera 6.500.000 lekë = 51.000 euro (deklaruar më parë)*. Kjo mënyrë deklarimi, në mosrespektim të detyrimeve të buruara nga ligji nr. 84/2016, nuk jep asnjë të dhënë për kohën e likuidimit të detyrimit të pashlyer, si dhe burimin e krijimit të shumës përkatëse, duke e përjashtuar përdorimin e deklaratës periodike si një provë për provimin e pretendimeve të subjektit.

16.20.3. *Së dyti*, në kontratën paraprake të shitblerjes, çmimi i shitjes së pasurisë prej 50.300 eurosh parashikohej të likuidohej: kësti i parë 26.000 euro paguar në datën e nënshkrimit të kontratës; kësti i dytë 10.000 deri në datën 30.03.2009; kësti i tretë 10.000 euro deri në datën 30.06.2009; kësti i katërt (i fundit) 4.300 euro deri në datën 30.08.2009. Përpos këstit të parë të paguar në vitin 2008 në rrugë bankare, shlyerja e çmimit të pasurisë në vitin 2009 e në vijim nuk ndjek parashikimet kontraktuale. Referuar kontratës së porosisë, parashikohet që firma ndërtuese do të dorëzojë apartamentet dhe garazhin të përfunduar brenda datës 31.12.2009³³. Subjekti ka deklaruar në Komision se dy apartamentet janë bashkuar në ndërtim. Nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK-ja Vlorë, rezultoi se apartamentet fillimisht janë regjistruar në vitin 2011 si pasuri më vete mbi bazën e kontratave të shitjes dhe më pas si një pasuri e vetme në datën 24.01.2014. Në kontratën paraprake dhe as në atë përfundimtare nuk ka parashikime lidhur me bashkimin e tyre/punime apo kostot për realizimin e tij. Për sa subjekti në DIPP-në 2009 deklaroi adresën e apartamentit si vendbanim dhe në Komision deklaroi se ka filluar të banojë në këtë apartament në *dhjetor 2009*, pretendimi i subjektit se firma ndërtuese nuk i është përmbajtur kushteve në lidhje me *përfundimin e punimeve dhe dorëzimin e certifikatës së pronësisë*, ku për këtë të dytën nuk ka asnjë parashikim në kontratë, nuk duket bindës e aq më pak që blerësi/subjekti të ketë poseduar pasuritë pa shlyer çmimin e shitjes. Në këtë situatë faktike të mosrespektimit të parashikimeve kontraktuale nga palët, të mungesës së ndonjë gjurme dokumentare për likuidimin e detyrimit ndaj firmës, të mosdeklarimit në DIPP-në respektive të detyrimit, shlyerjes së shumës

³³ Në kontratën e porosisë parashikohen penalitete për porositësit, për mosrespektim të afateve të kryerjes së pagesave pagimin e 0.5% në ditë të shumës së papaguar; për firmën ndërtuese, për mosdorëzimin e apartamenteve dhe garazhit në afat, 200 euro për çdo muaj vonesë.

dhe burimit të saj, shpjegimet e dhëna katër vite më pas për pasaktësitë e konstatuara nga ILDKPKI-ja vlerësohen se janë të sforcuara në funksion të ndreqjes së pasaktësive dhe nuk japin nivelin e duhur të besueshmërisë. Nga ana tjetër, pretendimi i një magjistrati, njohës i mirë i ligjit e subjekt deklarues prej vitit 2003, për *keqinterpretim të mënyrës së deklarimit*, është i papranueshëm, për sa në formularin për deklarim të detyrimeve financiare ndaj personave juridikë e fizikë jepet shpjegimi për të përshkruar qëllimin e *detyrimit financiar, shumën totale, datën e fillimit dhe mbarimit të detyrimit, numrin e kontratës dhe interesin bazë*.

16.20.4. *Së dyti*, lidhur me burimin e krijimit të shumës 700.000 lekë, subjekti pretendon se ka qenë gjendja e kursimeve *cash* në fund të vitit 2010, prej 1.000.000 lekësh, deklaruar prej tij në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 16.04.2015. Rezulton se për pasaktësitë e konstatuara nga ILDKPKI-ja, për *mosmbulimin e të ardhurave neto dhe pasurive neto për vitin 2011 në shumën 997.800 lekë*, subjekti ka shpjeguar që në vitin 2011 është pakësuar gjendja *cash*, në vlerën 700.000 lekë, si *diferencë e mbetur në blerjen e apartamentit*. Në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti deklaroi se *nuk e kisha kuptuar se nuk kam deklaruar gjendjen faktike të kursimeve të mia në shtëpi, pasi nuk më është dashur t'i përdor ose kontrolloj herë pas here. Mendoja se gjendja e tyre ishte aq sa kisha deklaruar pa kujtuar veprimet e marrjes së tyre për të mbuluar shpenzimet e vitit 2011. Megjithatë kur jam thirrur për të dhënë shpjegime kam deklaruar gjendjen reale dhe kjo jo siç është konstatuar nga Komisioni, "për sa kohë ato nuk janë ndrequr me vullnetin dhe iniciativën e vetë subjektit të rivlerësimit, por duket të jenë bërë në funksion të konstatimit të balancës negative nga ILDKPKI-ja". Në fakt ky duket si një mendim paragjykes nga ana e Komisionit dhe jo si mungesë kujtese nga unë dhe korrigjim i veprimeve të kryera. Unë garantoj se nuk kam pasur qëllim të mbuloj konstatimin e vlerës negative nga ILDKPKI-ja në atë vit, por vetëm atëherë jam kujtuar për veprimet*. Për pasaktësi të konstatuara në deklaratimet periodike, si për rastet e të tjera, subjekti pretendon se *duke qenë se nuk ka pasur një trajnim për plotësimin e deklaratës vjetore, sigurisht që në plotësimin e tyre ka edhe pasaktësi, që lidhen me keqinterpretim të rubrikave, harresa të cilat vijnë nga mosdhënia e rëndësisë sa duhej apo pakujdesi në plotësimin e tyre*. Sërish trupi gjykues sjell në vëmendje se, si subjekt deklarues prej vitit 2003 duket i pakuptim pretendimi për paqartësi në plotësimin e saktë të deklaratës së pasurisë dhe interesave dhe, aq më tepër, deklarimi rregullisht deri në vitin 2010 i shtimit të likuiditeteve *cash* e bën të pabesueshme *harresën apo pakujdesinë* për deklarimin e pakësimit të tyre në vitin 2011, për më tepër në një shumë të konsiderueshme dhe, sipas pretendimit, të përdorur si burim të krijimit të pasurisë e, për rrjedhojë, të detyrueshme për deklarim. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar ligji nr. 9049/2003 dhe formulari, në rubrikën përkatëse, faqja 3 e formularit, që i përket pasqyrimin të shtesave dhe ndryshimeve të interesave privatë dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për "[...] ndryshimet (shtesa dhe pakësime) nga "deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit" që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]. Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë duke parashikuar që deklaratat përbëjnë dokumente zyrtare dhe mospërmbushja e këtij detyrimi sillte pasoja për subjektet deklaruese.

16.20.5. Lidhur me gjendjen e kursimeve *cash*, konstatohet se përkundrejt asaj të deklaruar në deklaratat periodike vjetore të pasurisë³⁴, gjatë hetimit administrativ, ku i është kërkuar që mbi bazë të DIPP-ve të deklarojë gjendjen *cash* në fund të çdo viti, deklaratimet e subjektit kanë mospërputhje. Konkretisht, subjekti deklaroi pakësim të gjendjes *cash* në shumën 100.000 lekë në vitin 2009, 100.000 lekë në vitin 2010, 700.000 lekë dhe 3.000 euro në vitin 2011 (sipas procesverbalit të ILDKPKI-së në vitin 2015), pra, për vitet që konstatohet pamundësi financiare për mbulimin e shpenzimeve për pasuritë e deklaruara. Referuar shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI, lidhur me konstatimin *mosbulim në vitin 2011 me të ardhura neto të asetëve neto në shumën 997.800 lekë*, në të kundërt me sa pretendon se *deklarimi ka qenë i menjëhershëm*, konstatohet se në procesverbalin e datës 20.03.2015 subjekti ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash* pa deklaruar shifra dhe, në një procesverbal të dytë që mban datën 16.04.2015, subjekti ka shpjeguar se *gjendja cash është pakësuar 700.000 lekë si diferencë e mbetur në blerjen e apartamentit në Vlorë; në shumën 3.000 euro për pagesën e apartamentit dhe të garazhit në Komunën Farkë, Tiranë [subjekti ka shpjeguar se ka paguar 58.000 euro për apartamentin në Farkë, nga të cilat 50.000 i ka marrë hua, shuma 5.000 euro është nga kthimi i huadhënies (nga vjehri, siç do të analizohet në vijim, dhe shuma 3.000 euro nga pakësim i likuiditeteve cash)].* Sipas shpjegimeve të subjektit në këtë procesverbal, të cilave i qëndron në deklaratimet gjatë hetimit administrativ, gjatë vitit 2011 totali i pakësimit të kursimeve *cash* ka qenë një vlerë e konsiderueshme -700.000 lekë dhe 3.000 euro e, për rrjedhojë, pretendimi për *harrësë* të pakësimit të tyre duket jobindës, për më tepër që këto vlera pretendohen të jenë burim të shumave të shpenzuara po në vitin 2011 për krijimin e pasurive. Në këtë situatë faktike dhe ligjore ku pasaktësitë konsistojnë, jo vetëm në mosdeklarimin e pakësimit të kursimeve *cash*, por edhe në mosdeklarimin e burimit të krijimit të vlerës të pasurive të deklaruara, pretendimi për *moskuptim të rubrikave të deklaratës* konsiderohet si një përpjekje e subjektit për të justifikuar burimet e ligjshme lidhur me disa pasuri. Për më tepër, për pasurinë objekt kontrolli, shuma 700.000 lekë

³⁴ Në deklaratat e pasurisë deklarimet e subjektit janë si vijon:

- në DIPP-në e vitit 2003: “Gjendje cash 0.45, burimi kursime familjare”;
- në DIPP-në e vitit 2004: “Cash i mbartur 2003, depozitë Raiffeisen Bank, shtuar mars 2004, tërhequr tetor 2004, pakësuar 500.000 lekë (dhënë hua)”;
- në DIPP-në e vitit 2005: “Shtuar - kursime familjare nga të ardhurat e vitit 2005, 500.000 lekë”;
- në DIPP-në e vitit 2006 nuk ka deklaruar gjendje/shtesa/pakësime;
- në DIPP-në e vitit 2007: “Shtesa kursime nga të ardhurat 1.000 euro depozituar në Tirana Bank; 2.000 euro gjendje cash. Vlera: 3.000 euro”;
- në DIPP-në e vitit 2008: “Shtesë kursime nga të ardhura nga pagat, vlerë 4.000 euro = 500.000 lekë gjendje cash, tërheqje nga depozita pranë Tirana Bank krijuar në vitin 2007, vlera 1.000 euro gjendje cash”;
- në DIPP-në e vitit 2009: “Shtesë kursime nga pagat depozitë dhe cash. Vlera 300.000 lekë dhe 100.000 lekë depozitë Alpha Bank”;
- në DIPP-në e vitit 2010: “Shtesë kursime nga paga, vlerë 300.000 lekë. Pakësim tërheqje BKT 180.000 lekë”;
- në DIPP-të për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014 nuk ka deklaruar gjendje/shtesa/pakësime të likuiditeteve cash;
- në DIPP-në e vitit 2015: “Mbyllur llogaria pranë Veneto Bank (në emër të bashkëshortes), shtuar cash, vlera 119.419 lekë”;
- në DIPP-në e vitit 2016: “Pakësuar cash 119.419 lekë”.

nuk është deklaruar as si detyrim ndaj firmës ndërtuese në DIPP-të e viteve 2009-2010, për rrjedhojë pretendimi se pasaktësitë janë korrigjuar me shpjegimet në ILDKPKI, të dhëna katër vite më vonë dhe jo për shkak të deklarimeve të korrigjuara prej subjektit, por në përgjigje të shqetësimeve të ngritura nga ky organ, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar.

16.21. Në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit, lidhur me pasuritë “likuiditete në *cash*”, se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratimet periodike të pasurive dhe të interesave është mbizotërues, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e cila ka parashikuar në mënyrë të posaçme vlerën provuese të këtyre deklaratave në procesin e rivlerësimit kalimtar³⁵ dhe se mosdeklarimi i saktë i tyre pamundëson verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të rrjedhura prej tyre, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se për financimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 98 m² dhe garazh me sipërfaqe 25 m², në Vlorë, për sa i përket pagesës së kështit të dytë dhe të tretë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme në vlerën prej (-) 865.000 lekë [165.000 lekë për kështin e dytë dhe 700.000 lekë për kështin e tretë], për rrjedhojë gjendet në kushtet e germës “b”, të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

*C.2. Pasuria apartament banimi me sip. 95 m² dhe 2 garazhe me sip. 25 m², në vlerën 68.000 euro, në {***}, Tiranë*

17. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti deklaroi apartament banimi me sipërfaqe 95 m², vlerë 60.000 euro, pjesë takuese 50%, dy garazhe me sipërfaqe prej 14,57 m², me vlerë totale 8.000 euro, pjesë takuese 50%, blerë nga shoqëria “{***}” ShPK me kontrata shitblerje respektivisht me nr. {***}, datë 15.12.2014 dhe nr. {***}, datë 15.12.2014. Burim për krijimin e këtyre pasurive, subjekti deklaroi *huamarrje në vlerën 50.000 euro dhe 18.000 euro nga kursimet familjare*. Në formularin detyrime financiare ndaj personave fizik dhe juridik dhe në formularin të dhëna konfidenciale, subjekti deklaroi huamarrjen prej 50.000 eurosh nga shtetasi A. H., për blerjen e apartamentit në Tiranë, mbetur pa shlyer 32.000 euro. Subjekti deklaroi se për shkak të marrëdhënieve të posaçme me huadhënësin (nuni i vajzës) fillimisht akti i marrjes së huasë është një kontratë jonoteriale në datën 20.5.2011. Me deklaratën noteriale nr. {***}, datë 21.03.2015, është pranuar shlyerja në shumën 15.000 euro dhe është lidhur kontrata e huasë nr. {***}, datë 21.3.2015, për shumën 35.000 euro, me afat 21.03.2015 - 21.03.2026. Si burim të krijimit të shumës së huasë, subjekti deklaroi të ardhurat e huadhënësit nga kontrata e qirasë me Raiffeisen Bank, nr. {***}, datë 06.09.2006 - 1/3 e qirasë mujore prej 4.000 eurosh nga data 05.09.2006 e në vazhdim, si dhe nga aktiviteti privat furrë buke dhe prodhime brumërash nga viti 2003 e në vazhdim, fillimisht si person fizik dhe aktualisht si person juridik, si dhe ka depozituar dokumentacion justifikues në mbështetje të deklarimeve të tij³⁶.

³⁵ *Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, ndër të tjerë, nr. 11/2019 (JR); 19/2019 (JR); 20/2019 (JR) dhe 27/2020(JR).*

³⁶ *Subjekti ka paraqitur: (1) kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.3.2015; (2) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.03.2015; (3) kontratë huaje (jo noteriale) e datës 20.05.2011, bashkë me shënimet (nga mbrapa) për shlyerjen e kësteve; (4) certifikate pagëzimi lëshuar nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë*

18. Lidhur me këto pasuri, Komisioni ka konkluduar: (i) për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 98 m², subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave, si dhe personat e tjerë të lidhur/huadhënësit nuk kanë pasur burime të mjaftueshme për dhënien e huas, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016; (ii) për pasurinë garazhe, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 191.500 lekë dhe 3.000 euro për pagesën e garazheve në Tiranë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
19. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit dhe kërkon që vlera e huas të konsiderohet me të ardhura të ligjshme dhe të përfshihet në analizën financiare, duke pretenduar se përfundimi se personat e lidhur nuk kanë pasur burime të mjaftueshme për dhënien e huas është i pabazuar në provat e administruara dhe qëllimi i hetimit për personat e tjerë të lidhur është vetëm pasuria që afekton huadhënien, në përputhje me parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe orientimin e Kolegjit³⁷. Sipas subjektit, për të ardhurat e ligjshme të huadhënësve, Komisioni: (i) nuk ka llogaritur të ardhurat nga qiraja të periudhës shtator 2006 - janar 2007, si dhe kur kalimi i qirasë është bërë dorazi; (ii) nuk ka llogaritur saktë fitimin nga aktiviteti tregtar i huadhënësve, nga fillimi i tij deri në maj 2011 që ka qenë në shumën 20.884.461 lekë, ku edhe duke konsideruar shpenzimet e kryera prej tyre, 50.000 euro në vitin 2010, sërish huadhënësit rezultojnë me burime të mjaftueshme të të ardhurave të ligjshme për dhënien e huasë. Lidhur me kursimet familjare në vlerën 18.000 euro, subjekti kundërshtoi konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se kjo shumë është krijuar me të ardhura financiare të ligjshme: (i) huaja prej 500.000 lekësh dhënë në formë ndihme vjehrrit S. A. në vitin 2004 është kthyer prej tij në vitin 2011 në shumën 5.000 euro, po në formë ndihme në kuadrin e marrëdhënieve familjare pa asnjë interes apo qëllim fitimi, për rrjedhojë nuk ka pasur detyrim për shlyerje të detyrimeve tatimore dhe kjo shumë duhet të përfshihet në analizën financiare; (ii) shuma 3.000 euro është krijuar nga pakësimi i gjendjes *cash*, deklaruar në ILDKPKI nëpërmjet DIPPP-vë deri në vitin 2010, pasaktësitë në plotësimin e të cilave nga pakujdesia apo harresa janë saktësuar në procesverbalin e ILDKPKI-së, po ashtu edhe përgjigje të pyetësorit nr. 2; (iii) për shumën 5.000 euro, si pagesë kësti për apartamentin në datën 10.05.2013, për të cilën Komisioni konkludon se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për pagesën e saj, duhen të konsiderohen shpjegimet dhe provat e depozituara prej tij, lidhur me këstin e huasë dhe shpenzimet e arredimit, nga përpjesëtimi i të cilave në mënyrë të barabartë për katër vite do të rezultonte vlera prej 175.000 lekësh për vitin 2013; (iv) për shumën 5.000 euro, si pagesë kësti për apartamentin në datën 13.12.2014, shpjegimet e tij për zëra të analizës financiare si shpenzimet jetike, të arredimit dhe të gjendjes së kursimeve, të cilat nuk janë marrë në konsideratë prej Komisionit, bëjnë që situata e vitit 2014 të jetë me tregues financiarë pozitivë për mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe kryerjen e pagesës.

*seria nr. {***}, datë 29.05.2010; (5) kontratë qiraje, datë 05.09.2006, me palë qiradhënëse shtetasit A. H., A. K. e V. Ll. dhe palë qiramarrëse Raiffeisen Bank; (6) ekstrakt historik nga QKR, i printuar më datë 24.03.2015, i personit fizik “A. H.”; (7) ekstrakt historik nga QKR, i printuar më datë 24.03.2015, i personit fizik “E. H.”.*

³⁷ Subjekti referon vendimin nr. 15/2019(JR) të Kolegjit që i përket subjektit D. Rr., paragrafin 110 të tij.

20. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me pasuritë apartament banimi me sipërfaqe 95 m², në vlerën 60.000 euro dhe 2 garazhe në vlerën 8.000 euro, në {***}, Tiranë, vlerëson se qëndron konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e kësaj pasurie, për pagesën e këstit të fundit në vitin 2014, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Analiza e trupit gjykues shtjellohet në detaj në vijim.

20.1. Së pari, nga aktet në fashikuj, konstatohet si vijon:

- Në deklaratat e pasurisë subjekti deklaron:

(i) Në DIPP-në 2011- kontratë porosie për banesë + garazh me firmën “{***}” ShPK [nr. {***} rep., datë 5.6.2011 dhe nr. {***} rep., datë 3.12.2011], Komuna Farkë, paguar 58.000 euro, pjesë takuese 50%. Në formularët përkatës deklaron hua nga A. H. në shumën 50.000 euro për blerje banese me afat 15 vjet - marrëveshje shkresore për shkak të marrëdhënies së posaçme.

(ii) Në DIPP-në 2013 - pagim kësti për banesë për firmën “{***}” ShPK në shumën 5.000 euro nga llogaria në Alpha Bank + 25.000 lekë kursime; detyrim të pashlyer ndaj firmës në vlerën 3.000 euro³⁸. Lidhur me huanë e marrë nga shtetasi A. H. deklaron shuma e shlyer 3.500 euro (nga kursimet familjare të vitit 2013) dhe detyrim të mbetur pa shlyer 42.500 euro.

(iii) Në DIPP-në 2014 - shtuar apartament banimi + 2 vendparkime Komuna Farkë, me numrat përkatës të regjistrimit të pasurive; lidhur me detyrimet financiare ndaj firmës “{***}” ShPK, deklaron pagesën e këstit përfundimtar për banesën në Komunën Farkë në shumën 5.000 euro, nga shitja e automjetit dhe kursimet familjare, dhe se nuk ka detyrime; lidhur me huanë e marrë nga shtetasi A. H. deklaron shumë të shlyer 3.500 euro, nga kursimet familjare, detyrim të mbetur pa shlyer 39.000 euro .

(iv) Në DIPP-të 2015 dhe 2016: lidhur me huanë e marrë nga shtetasi A. H., deklaron respektivisht: shlyer 4.000 euro nga kursimet familjare e të ardhurave nga pagat, gjendja e mbetur pa shlyer 35.000 euro; shlyer 3.000 euro nga kursimet familjare e të ardhurave nga pagat, gjendja e mbetur pa shlyer 32.000 euro.

*Marrëdhënia mes subjektit të rivlerësimit dhe firmës “{***}” ShPK për shitblerjen e pasurive, dokumentohet si vijon:*

(i) Në kontratën e porosisë, datë 05.06.2011³⁹, çmimi i apartamentit pasqyrohet 60.000 euro, për të cilin palët deklarojnë likuidimin nga porositësi të 50% e vlerës në datën 05.06.2011, dy pagesa prej 20% të vlerës totale respektivisht në datat 10.10.2011 dhe 20.12.2011, si dhe 10% të vlerës totale me marrjen e çelësave.

³⁸ Ndërkohë që, sipas deklarimeve të subjektit, vlera e mbetur pa shlyer duhej të ishte 5.000 euro, si diferenca midis shumës totale 68.000 euro dhe vlerës 58.000 euro të paguar në 2011 dhe vlerës 5.000 euro të paguar në 2013.

³⁹ Kontrata nr. {***}, datë 05.06.2011, notere M. Sh..

(ii) Në kontratën e porosisë së garazheve⁴⁰, datë 05.06.2011, pasqyrohet çmimi 8.000 euro dhe se është likuiduar e gjithë vlera totale në datën 03.12.2011.

(iii) Në kontratën e shitblerjes së apartamentit me sip. 95 m², me nr. pasurie {***}, z. k. {***}, me vendndodhje {***}, Tiranë, datë 15.12.2014⁴¹, pasqyrohet se çmimi i shitjes, prej 60.000 eurosh është likuiduar totalisht nga pala blerëse, sipas përcaktimit në kontratën e porosisë dhe palës blerëse i është dorëzuar apartamenti.

(iv) Me kontratën e shitblerjes së dy garazheve me nr. pasurie {***} dhe nr. {***}, z. k. {***}, me vendndodhje në {***}, Tiranë, datë 15.12.2014⁴², me çmim 4.000 euro secilit (totali 8.000 euro), pasqyrohet se shumat janë likuiduar totalisht nga pala blerëse, sipas përcaktimit në kontratën e porosisë me nr. {***}, datë 3.12.2011.

(v) Nga dokumentacioni i administruar⁴³, rezulton se çmimi i pasurive është likuiduar: në datën 05.06.2011 - shuma 50.000 euro [sipas mandatarkëtimit të shoqërisë “{***}” ShPK, nr. {***}, datë 05.06.2011, me përshkrimin *arkëtim kësti për apartamentin nr. {***}, kuota 9.69*]; në datën 03.12.2011- shuma 8.000 euro, me përshkrimin *likuidim total garazhe*; në datën 10.05.2013 - shuma 5.000 euro me përshkrimin *arkëtim apartamenti*; në datën 13.12.2014 - shuma 5.000 euro me përshkrimin *mbyllje llogarie*.

Lidhur me huanë 50.000 euro, nga aktet në fashikuj dokumentohet si vijon:

(i) Në datën 20.05.2011, subjekti dhe bashkëshortja (huamarrës) dhe shtetasi A. H. (huadhënësi) nënshkruajnë “kontratë huaje”, shkresë e thjeshtë, për dhënien e huas në shumën 50.000 euro, me afat 15 vjet, pa interes, me qëllim përdorimi për blerjen e një banese në qytetin e Tiranës. Huamarrësit detyrohen t’i paguajnë huadhënësit për 10 vitet e para shumën 3.000 euro/vit brenda muajit maj, për 5 vitet e tjera shumën 4.000 euro/vit; në rast të kërkesës së huadhënësit, huamarrësit brenda 3 muajve do t’i kthejnë shumën 30.000 euro, kurse shuma tjetër do të likuidohet sipas kushteve të mësipërme nga 4.000 euro/vit. Në faqen e pasme të kontratës, me shkrim dore dhe nënshkrim të A. H., pasqyrohen marrja e shumave 4.000 euro për vitin 2012; 3.500 euro për vitin 2013; 3.500 euro për vitin 2014; 4.000 euro për vitin 2015; 3.000 euro për vitin 2016 [të njëjtat shuma deklarohen prej subjektit në DIPP-të respektive].

(ii) Sipas procesverbaleve të ILDKPKI-së datë 20.03.2015 dhe atij vijues në datën 16.04.2015, lidhur me shpjegimet e kërkuara, nëse ka deklaratë noteriale për të vërtetuar huan 50.000 euro

⁴⁰ Kontratë porosisë nr. {***}, datë 05.06.2011, paraqitur nga subjekti në dokumentacionin e dorëzuar në ILDKPKI, konfirmuar nga shoqëria “{***}” ShPK dhe nga notere M. Sh. me shkresën nr. {***} prot., datë 10.5.2021, të noterit S. Sh..

⁴¹ Kontrata nr. {***}, datë 15.12.2014, lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK përfaqësuar nga administratori A. D. dhe subjektit.

⁴² Kontrata nr. {***}, datë 15.12.2014, lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK përfaqësuar nga administratori A. D. dhe subjektit.

⁴³ Shkresa e IKDKPKI nr. {***} prot., datë 23.04.2021 dhe shkresa e shoqërisë “{***}” ShPK, nr. {***}, datë 03.05.2021, sipas të dhënave të librit t arkës lidhur me pagesat e kryera, raporti “ditar klienti”, i nxjerrë nga programi i tyre financiar.

dhe si mund të vërtetohet aftësinë financiare të personit, subjekti deklaroi se huadhënësi është kumbari i vajzës dhe ka paraqitur “certifikatë pagëzimit” të Kishës Autoqefale të Shqipërisë, me nr. Serie {***}, nr. regj. {***}, datë 29.05.2010, deklaratë noteriale të huadhënësit, kontratën e huasë nënshkruar para noterit në datën 21.03.2015 dhe lidhur me aftësitë financiare të huadhënësit ka paraqitur dokumentin nga QKR-ja për aktivitetin e tij tregtar, kontratën e qirasë me Raiffeisen Bank të lidhur në vitin 2006, si dhe dokumente për jetesën dhe punën në Greqi⁴⁴.

(iii) Nga aktet noteriale si më lart referuar, të paraqitura në ILDKPKI dhe bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit të pasurisë, rezultoi se: - në kontratën noteriale të huasë, lidhur mes subjektit dhe shtetasit A. H. në datën 21.03.2015⁴⁵, deklarohet se në datë 20.05.2011 subjekti/huamarrësi ka marrë në dorëzim shumën 35.000 euro, me afat 11 vjet, shlyerja do të bëhet me këste ose tërësisht, sipas dëshirës së huamarrësit, po jo më pak se 3.000 euro/vit dhe me akt shkresor, si dhe parashikohen penalitetet për moskthimin në rrugë vullnetare; - në deklaratën noteriale shtetasi A. H.⁴⁶ deklaroi se i ka dhënë subjektit në datën 20.05.2011 huanë prej 50.000 eurosh, me shkresë të thjeshtë, për shkak të marrëdhënies specifike familjare (ai dhe bashkëshortja i kanë pagëzuar vajzën). Nga kjo shumë janë likuiduar 15.000 euro për vitet 2012-2015, të dorëzuara *cash*.

21. Lidhur me huanë 50.000 euro, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave, si dhe personat e tjerë të lidhur/huadhënësit nuk kanë pasur burime të mjaftueshme për dhënien e huasë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion bazohet në përfundimet se: (i) nuk krijohet bindja për marrjen e kësaj huaje nga subjekti rivlerësimit duke konsideruar vlerën e konsiderueshme të huasë, dhënien e saj për një periudhë të gjatë rreth 15-vjeçare, pa interes e pa dokument shkresor përpara noterit, por të përpiluar vetëm pas pyetjes së subjektit nga ana e ILDKPKI-së, dhënien e saj jo për nevojë emergjente, por për blerjen e një shtëpie të dytë; (ii) subjekti rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me mjaftueshmërinë e burimeve financiare të personave të tjerë të lidhur/huadhënësve për dhënien hua të shumës 50.000 euro në datën 20.5.2011, për rrjedhojë në analizën financiare Komisioni nuk ka pasqyruar marrjen dhe kthimin e kësaj huaje.
22. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit si të pabazuar në provat e administruara dhe duke referuar qëndrimin e mbajtur nga Kolegji⁴⁷ pretendon se duke mos hetuar

⁴⁴ Subjekti ka paraqitur kopje të dokumenteve në gjuhën greke të shtetasve A. dhe E. H., kopje pasaportës së A. H., ku pasqyrohet viza e shtetit grek e vitit 1997 dhe një kopje vize ku nuk dallohet periudha, si edhe disa dokumente të tjerë, që pasqyrojnë të ardhura në valutën drahmi greke, por të padallueshme qartësisht.

⁴⁵ Kontratë huaje me nr. {***}, datë 21.03.2015, notere F. Sh..

⁴⁶ Deklaratë noteriale nr. {***}, datë 21.03.2015, notere F. Sh..

⁴⁷ Referuar vendimit nr. 15/2019(JR) të Kolegjit, që i përket subjektit D. Rr., subjekti citon paragrafin 110 të tij: “Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër,

vetëm pasurinë që *afekton huadhënien* Komisioni ka tejkeluar qëllimin e hetimit të pasurisë së personave të lidhur/huadhënësve. Duke parashtruar argumente lidhur me provueshmërinë e akteve të kohës me të cilat është formalizuar marrëdhënia e huasë, të deklarimeve të tij në DIPP për ekzistencën e marrëdhënies së huasë, si dhe lidhur me mundësitë e huadhënësve për dhënien e huasë me burime të ligjshme, subjekti kërkon që vlera e huas të konsiderohet me të ardhura të ligjshme e të përfshihet në analizën financiare.

22.1. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit dhe akteve në fashikuj, nuk e gjen të bazuar përfundimin e Komisionit *se nuk krijohet bindja për marrjen e kësaj huaje*. Trupi gjykues, *së pari*, çmon të sjellë në vëmendje se deklarimi i huasë si detyrim në deklaratën e pasurisë të vitit korrent të marrjes së saj dhe i të dhënave për huadhënësin në formularin respektiv, si dhe deklaratimet për shlyerjen e saj në deklaratat e pasurisë të viteve vijuese, kanë vlerë provuese në këtë proces, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Këto prova të vlerësuara në unitet me provat e tjera të administruara, të krijuara jo në funksion të procesit të rivlerësimit nuk e përjashtojnë *a priori* dhënien e huasë për arsyet e renditura prej Komisionit. Konkretisht, dokumentimi i dhënies së huasë, fillimisht me shkresë të thjeshtë në vitin 2011, por që provon gjithësesi kohën e lindjes së marrëdhënies dhe jep besueshmëri rreth ekzistencës së saj duke qenë se është deklaruar si e tillë në DIPP-në e vitit 2011 e më pas me akt të përpiluar përpara noterit në vitin 2015, ku pasqyrohet dhënia e huasë në vitin 2011, kushtet dhe shuma e shlyer deri në atë moment, deklarata noteriale e huadhënësit në vitin 2015 ku deklarohet dhënia e huasë, kushtet dhe shuma e shlyer, dokumenti certifikatë pagëzimi lëshuar nga Kisha Autoqefale e Shqipërisë, me nr. serie {***}, nr. regj. {***}, datës 29.05.2010, ku bashkëshortja e huadhënësit pasqyrohet si nuni i vajzës së subjektit, i paraqitur edhe në ILDKPKI në vitin 2015, duket të dëshmojnë se huaja është dhënë në kushte favorizuese për huamarrësin/subjektin, për shkak të ekzistencës së një raportit familjar më shumë se miqësor. Në këtë kontekst, trupi gjykues sjell në vëmendje se rezultatet e hetimit administrativ shterues të kryer prej Komisionit, nga ku ka rezultuar e provuar se subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me huadhënësin A. H. dhe bashkëshorten e tij E. H., përjashtojnë dyshime lidhur me huadhënien sipas kushteve të pasqyruara në dokumentet e kohës, sipër referuar.

Në vijim, pavarësisht analizës si më sipër dhe provave sipërcituar, trupi gjykues çmon se analizimi dhe provueshmëria e mundësive financiare të huadhënësve për dhënien e huasë në shumën 50.000 euro, krijon bindjen e trupit gjykues lidhur me këtë huadhënie. Lidhur me analizimin e mundësive të huadhënësve për dhënien e huasë, trupi gjykues, *së pari*, shqyrtoi pretendimin e subjektit se duket sikur Komisioni ka si subjekt rivlerësimi huadhënësit si persona të tjetër të lidhur, ndërkohë që ligji shpreh qartë se në rastin e tyre qëllimi i hetimit është vetëm i asaj pasurie që afekton

personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive”.

huadhënien. Ky pretendim i subjektit u analizua prej trupit gjykues sipas një analize gjithëpërfshirëse si në vijim.

22.1.1. Në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, në *formatin të dhëna konfidenciale*, subjekti deklaroi shumën e huasë së dhënë nga A. H., burim të pasurisë së huadhënësit deklaroi qiranë, nga kontrata e qirasë me nr. {***}, datë 06.09.2006, me Raiffeisen Bank, ku përfiton 1/3 e qirasë mujore prej 4.000 eurosh nga data 05.09.2006 e në vijim. Në këtë format, gjithashtu, subjekti deklaroi se huadhënësi zhvillon aktivitet privat furrë buke dhe prodhime brumërash nga viti 2003 e në vazhdim, fillimisht si person fizik dhe aktualisht si person juridik.

22.1.2. Gjatë hetimit administrativ, lidhur me kërkesën e Komisionit për të paraqitur dokumentacion provues *për burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit* për huanë 50.000 euro, krahas kontratës së qirasë me Raiffeisen Bank, subjekti ka paraqitur ekstrakte të QKR-së për regjistrimin si person fizik të A. H. dhe të E. H., bashkëshortja e huadhënësit, respektivisht me datë regjistrimi 19.02.2003 dhe 15.02.2005, si dhe deklaratën e të ardhurave individuale të shtetasit A. H. për vitin 2011, ku janë deklaruar gjithsej 4.529.604 lekë nga të cilat 3.423.444 lekë të ardhura nga qiratë. Për rrjedhojë, me provat e paraqitura, vetë subjekti ka dalë përtej deklaramit se të ardhurat nga qiratë janë burim i dhënies së huasë, duke paraqitur dokumentacion justifikues edhe për bashkëshorten e huadhënësit, e cila, referuar akteve që dokumentojnë huadhënien, nuk ka statusin e huadhënëses, por referuar parashikimeve të Kodit të Familjes nuk do të ishte e përjashtuar për shkak të institutit të bashkësisë ligjore. Për rrjedhojë, me dokumentacionin e paraqitur, vetë subjekti duket të ketë qenë i interesuar për zgjerimin e hetimit administrativ lidhur me mundësitë e shtetasit A. H. për dhënien e huasë, sa i përket aktivitetit të tij tregtar, po ashtu edhe për aktivitetin tregtar të bashkëshortes së këtij shtetasi, të cilët, me të ardhura të konsiderueshme dhe detyrime tatimore të shlyera⁴⁸, ofronin garanci të shtuar për të provuar mundësitë e huadhënies dhe ligjshmërinë e të ardhurave të huadhënësve, detyrime të buruara nga ligji nr. 84/2016. Njëherazi, shumat e qirave të përfituara nga kontrata në shtator 2006 me Raiffeisen Bank, të depozituara në llogari bankare të shtetasit A. H., ku janë depozituar të ardhura nga veprimtaria tregtare apo janë tërhequr likuiditete, passjellin që lidhur me mundësinë e dhënies së huasë kontrolli të shtrihet mbi të gjithë pasuritë e huadhënësve, për sa aktiviteti dhe veprimtaria e huadhënësve i ndërlidhin ato mes tyre. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit, *për të konsideruar të arsyeshme kufizimin në kohë, sipas dokumentacionit ligjor provues të paraqitur, edhe për shkak*

⁴⁸ Me shkresën nr. {***} prot., datë 07.01.2021, QKB-ja informon:

(i) shtetasi A. H.:

- në bazë të vendimit të Gjykatës Gjyrokastër të datës 23.01.2002 është regjistruar si person fizik me fushë veprimtarie furrë buke dhe është çregjistruar në datën 01.03.2016;
- është ortak në shoqërinë "{***}" ShPK që është regjistruar në datën 29.04.2008, me kuotë 50 % dhe vazhdon të jetë aktive;
- në datën 20.10.2015, është bërë regjistrimi i shoqërisë "{***}" ShPK me fushë veprimtarie furrë buke dhe prodhime brumërash, ku ortak i vetëm i saj është shtetasi A. H. dhe vazhdon të jetë aktive.

(ii) shtetasja E. H. është regjistruar si person fizik në datën 15.02.2005 me fushë veprimtarie furrë buke dhe prodhime brumërash dhe se është çregjistruar në datën 03.03.2016.

të një arsyetimi logjik se verifikimi i të ardhurave të personit tjetër të lidhur jo detyrimisht duhet të përfshijë të gjithë periudhën gjatë së cilës ai ka realizuar të ardhura, por aq sa është e përshtatshme/nevojshme dhe proporcionale në lidhje me shtrirjen në kohë të krijimit të pasurisë, për sa nuk rezultojnë pretendime apo fakte që e lidhin fitimin e saj me një moment të caktuar kohor, me qëllim provimin e ligjshmërisë së burimit për vlerën që është objekt dhurimi apo huaje, kontrolli i ushtruar prej Komisionit vlerësohet nga trupi gjyqësor i nevojshëm për shkak të rrethanave të faktit, shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit ligjor provues të paraqitur prej tij dhe, si i tillë, i përshtatshëm dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016.

22.1.3. Me rezultatet e hetimit administrativ, ku për bashkëshortët H., të konsideruar *persona të tjerë të lidhur* me subjektin e rivlerësimit, janë përlllogaritur fitimet nga fillimi i aktiviteteve tregtare respektive në shumën 12.486.771 lekë, të ardhurat nga qiradhënia për periudhën 1.01.2007-20.05.2011 në shumën 7.170.917 lekë (54.774 euro), gjendja e llogarive bankare në datën 20.05.2011 në shumën 10.120.379 lekë; shpenzime jetike për periudhën 2003-maj 2011 në shumën 4.190.796 lekë; transferta bankare për të tretë për blerje pasurish së paluajtshme në shumën 25.077.000 lekë, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me gjetjen *duket se personat e tjerë të lidhur/huadhënësit nuk kanë pasur burime të mjaftueshme për dhënien huasë në shumën 50.000 euro në datën 20.05.2011, pasi i ka rezultuar se ata nuk kanë tërhequr nga llogaritë bankare shumën prej 50.000 eurosh gjatë periudhës 01.01.2011 – 20.5.2011, se në arkën e biznesit nuk duket se mbajnë vlera të larta të likuiditeteve cash, si dhe kanë investuar shumën 200.000 euro në pasuri të paluajtshme në vitet 2008 – 2011.* Komisioni ka vlerësuar se në përmbushje të barrës së provës subjekti ka dhënë shpjegime vetëm për ligjshmërinë e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur dhe nuk argumentoi apo provoi mjaftueshmërinë e likuiditeteve të tyre në momentin e dhënies së huas.

22.1.4. Në ankim, subjekti parashtroi se pyetja e vetme që shtrohet është *a kishin mundësi huadhënësit për dhënien e huasë me të ardhura të ligjshme* dhe renditur pretendimet për të ardhura më të mëdha të huadhënësve se sa i kanë rezultuar Komisionit: (i) nga aktiviteti tregtar në shumën 20.884.461 lekë përkundëjt shumës 12.486.771 lekë të llogaritur prej Komisionit; (ii) të ardhurat nga qiratë kanë qenë në shumën 8.746.658 lekë, shuma e përlllogaritur nga Komisioni prej 7.170.917 lekësh (54.774 euro) rezulton vetëm nga qiratë e kaluara në rrugë bankare pa marrë parasysh ato të dhëna dorazi dhe pa përfshirë qiratë e periudhës shtator 2006-janar 2007; (iii) të ardhura nga emigracioni në shumën 150.000 euro, të pa llogaritura prej Komisionit; (iv) për shpenzimet e përmendura në vendim të cilat janë të shpërndara në kohë pagesa e fundit është bërë në datën 11.01.2008. Nga ky moment e deri në dhënien e huasë në maj 2008 të ardhurat e huadhënësve nga aktiviteti tregtar dhe qiratë janë përafërsisht në shumën 9.000.000 lekë dhe 48.000 euro, sipas analizës financiare të audituesit A. M. të kontaktuar prej tij, ndërsa sipas analizës financiare të Komisionit rezultojnë përafërsisht në shumën 5.200.000 lekë. Gjithashtu, duke parashtruar se për personat e tjerë të lidhur legjislacioni nuk parashikon kufizime për mënyrën e mbajtjes së të ardhurave në bankë apo *cash*, huadhënësi është person i njohur në qytet për aktivitetin e tij tregtar, nuk e kishte të vështirë për të gjetur një sasi të hollash në një moment të

caktuar, për sa tërheqja e të hollave në bankë është e lidhur me shumë faktorë, procedurat dhe kohën e nevojshme për kryerjen e veprimeve për tërheqjen e shumave mbi 500.000 lekë, cenimin e interesave bankare etj., subjekti pretendon se përfundimet e Komisionit – se shumata e huasë nuk është tërhequr nga llogaritë bankare të huadhënësve në periudhën janar-maj 2011 dhe se në arkën e biznesit huadhënësit nuk duket se mbajnë vlera të larta të likuiditeteve *cash* – nuk përmbajnë asnjë argument ligjor, janë qëndrime subjektive, hamendësime dhe paragjykitime të pabazuara në prova.

22.2. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se me hetimin e kryer për mundësitë financiare të huadhënësve Komisioni nuk ka vepruar në kundërshtim me orientimin që Kolegji ka dhënë për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, bazuar në parashikimet e paragrafit 2, neni 66 të ligjit nr. 84/2016. Lidhur me zbatimin e parashikimit të pikës 4, neni 32 të ligjit nr. 84/2016 - *subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*, në qëndrimin e mbajtur, Kolegji⁴⁹ ka vlerësuar se: (i) subjekti i rivlerësimit ka barrën të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila i dhurohet ose i jepet hua prej personit tjetër të lidhur; (ii) për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre.

22.3. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit, si më sipër referuar, trupi gjykues vlerëson, *së pari*, edhe me sa i ka rezultuar Komisionit⁵⁰, se provohet se huadhënësit potencialisht kishin të mundur realizimin me burime të ligjshme të shumës së dhënë hua. Pretendimet e subjektit, lidhur me realizimin e të ardhurave më të mëdha nga huadhënësit, si nga aktiviteti tregtar, ashtu dhe nga qiraja apo emigracioni, ndonëse mbetën të paprovuara, sipas standardit të së ardhurës së ligjshme të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm, u analizuan nga trupi gjykues, në funksion të vlerësimit të arsyeshëm e të logjikshëm të të gjithë situatës financiare të huadhënësve, për të arritur në një konkluzion sa më afër realitetit jetësor drejt mundësisë së tyre për më shumë likuiditete apo burime nga sa mund të provohen në këtë proces.

22.4. *Së dyti*, nga kontrolli i llogarive bankare të personave të lidhur për periudhën janar 2010-maj 2011, rezultoi se megjithëse depozitimet *cash* janë në vlerë më të madhe se tërheqjet *cash*⁵¹, vlera totale e tërheqjeve *cash* (13.046.350 lekë + 39.963 euro) është më e madhe sesa shumata e dhënë hua, duke lënë jashtë llogaritje në këtë kuptim, shumata të cilat janë transferuar në llogari të tjera bankare për të financuar investimet e huadhënësve të kryera në këtë periudhë, të cilat duket

⁴⁹ *Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit nr. 12/2018 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit B. D.; nr. 14/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit A. B.; nr. 15/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit D. Rr. nr. 20/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit G. O..*

⁵⁰ *Cituar në paragrafin 19.2.3 të vendimit objekt gjykimi.*

⁵¹ *Janë depozituar 16.088.536 lekë dhe tërhequr 13.046.350 lekë [diferenca (-) 3.042.186 lekë]; janë depozituar 47.700 euro dhe tërhequr 39.963 euro [diferenca 7.737 euro].*

se në kuptimin financiar vënë këta të fundit në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme sipas Komisionit. Pavarësisht mungesës së informacionit për burimin e krijimit të shumave të depozituara, si dhe informacionit nëse shumat e tërhequra janë shpenzuar totalisht, trupi gjykues, në konsideratë të faktit se huadhënësit kanë të ardhura të ligjshme për të përballuar krijimin e shumës prej 50.000 eurosh të dhënë hua, e vlerëson këtë situatë pa një peshë përcaktuese e në arritjen e konkluzionit për burimet e përdorura për krijimin e shumës së marrë në analizë.

22.5. Në vlerësimin e trupit gjykues, huadhënësit duke qenë se plotësojnë kriterin ligjor të pasjes së burimeve për të krijuar shumën e dhënë hua, krahas përballimit po me të ardhura të ligjshme të shpenzimeve jetike, sipas një standardi orientues të jurisprudencës së Kolegjit, duhen konsideruar se mund të kenë përballuar shpenzimet për investimet e kryera nëpërmjet burimeve të tjera, të cilat subjekti nuk arriti t'i dokumentojë, sipas standardit të së ardhurës së ligjshme, por që gjithsesi provohet se kanë ekzistuar. Lidhur me këto burime, trupi gjykues mbajti në konsideratë: (i) të ardhura të krijuara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortëve H., i cili pretendohet se ka qenë në nivele më të larta se ai i pranuar nga Komisioni dhe Kolegji, në vijim të një mesatareje të pranuar edhe për rastet e tjera të marra në shqyrtim. Sipas analizës në Kolegj, mesatarja e fitimit për këto aktivitete “furrë buke dhe prodhime brumërash” është pranuar se është në një normë fitimi, ndonëse nuk konsiderohet krejtësisht i pabazuar pretendimi i subjektit i evidentuar në aktin e ekspertit kontabël A. M. se ky aktivitet ka një normë më të lartë fitimi: (ii) të ardhurat nga qiraja janë konsideruar vetëm në vlerën e pranuar se është derdhur nëpërmjet trasfertës bankare, ndonëse këto shuma nuk mbulojnë të gjithë periudhën për të cilën është lidhur kontrata e qirasë, e cila në mungesë të ndonjë argumenti faktorial të ndryshëm ka vijuar të japë të njëjtin produkt për huadhënësit edhe pse jo nëpërmjet rrugës bankare; (iii) të ardhurat nga emigracioni për huadhënësit janë konsideruar në vlerën 0 (zero), ndonëse subjekti pretendon se ata kanë emigruar qysh nga viti 1991 dhe nga dokumentacioni që subjekti ka paraqitur provohet se A. H. ka qëndruar në Greqi për një periudhë kohe prej vitit 1997 dhe natyrshëm ka krijuar të ardhura, sipas qëllimit që çdo shtetas shqiptar ka pasur në emigracion; (iv) pavarësisht se nuk rezultojnë të dhëna nga QKR-ja, huadhënësi A. H. rezulton të jetë aksionar edhe në shoqërinë “{***}” ShPK, aktivitet në fushën e ndërtimeve, që ndonëse nuk ka arritur të dokumentojë prodhimin e të ardhurave, sugjeron për krijimin e tyre dhe pasjen mundësi të likuiditeteve. Të dhënat e mësipërme krijuan bindjen se huadhënësit, ndërsa kishin të ardhura të ligjshme për krijimin e shumës prej 50.000 eurosh të dhënë hua, duke plotësuar kriteret e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duket se kishin mundësi dhe burime të ligjshme për të justifikuar në një nivel të arsyeshëm edhe investimet e kryera përtej kësaj shume, duke pranuar në këtë mënyrë që huaja të konsiderohet si një e ardhur në analizën financiare për blerjen e pasurisë së subjektit. Në logjikë të këtij konkluzioni, trupi gjykues, jo vetëm që kreditoi me të ardhura analizën financiare të subjektit për vlerën prej 50.000 euro, por edhe e ngarkoi atë me detyrimin për shlyerjen e saj, sipas deklarimeve të subjektit në DIPP-të respektive, elementë që ndikuan analizën financiare të tij në ndryshim nga logjika që kishte përdorur Komisioni.

Lidhur me burimin - kursimet familjare në vlerën 18.000 euro

➤ *Shuma 8.000 euro, datë 03.12.2011 (pagesa për garazhet)*

22.6. Së pari, nga aktet në dosje rezulton si vijon:

(i) Në datën 03.12.2011, subjekti dhe shoqëria “{***}” ShPK nënshkruajnë kontratën e porosisë⁵² për 2 vendparkime (garazhe), me sipërfaqe totale 70 m², çmim 8.000 euro për të cilin deklarohet se u likuidua nga porositësi në po të njëjtën datë. Kryerja e pagesës 8.000 euro nga subjekti në datën 03.12.2011, pasqyrohet edhe në kontratën e shitjes së garazheve nr. {***}, datë 15.12.2014, si dhe në dokumentacionin e përcjellë nga shoqëria “{***}” ShPK në Komision.

(ii) Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se pagesa për garazhet prej 8.000 eurosh është bërë në datën 31.12.2011 (në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë), ku 5.000 euro janë siguruar nga kthimi i borxhit prej S. A. (babai i bashkëshortes) dhe 3.000 euro nga pakësimi i gjendjes *cash* prej 5.000 eurosh në fund të vitit 2010.

(iii) Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti deklaroi huanë e dhënë shtetasit S. A. në shumën 500.000 lekë dhe në seksionin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme “*cash*” i mbartur prej vitit 2003. Depozitë në Raiffeisen Bank shtuar mars 2004 tërhequr tetor 2004, pakësuar 500.000 lekë (dhënë hua). Në DIPP-në e vitit 2011 ka deklaruar kthimin e huasë së dhënë në vitin 2004 në shumën 5.000 euro.

(iv) Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 16.04.2015, në përgjigje të konstatimit të ILDKPKI-së, lidhur me mosbulimin e të ardhurave *neto* dhe asetëve *neto* për vitin 2011, subjekti ka deklaruar se këtë vit ka pakësuar gjendjen *cash* nga kursimet ndër vite, konkretisht gjendja *cash* është pakësuar 3.000 euro për pagesën e garazhit. Pra, për ta specifikuar, ka vijuar subjekti, ka paguar 58.000 euro në apartamentin në Farkë, nga të cilat 50.000 euro i ka marrë hua, shuma 5.000 euro është nga kthimi i huadhënies dhe shuma 3.000 euro është nga pakësimi i gjendjes *cash*.

➤ *Huaja në vlerën 500.000 lekë, kthyer 5.000 euro*

22.7. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me marrëdhënien e huasë mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit S. A. [babai i ndjerë i bashkëshortes së subjektit], Komisionit i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për dhënien e huasë në shumën 500.000 lekë [sipas analizës financiare për periudhën 1998 – 2003 (krijimi i kursimeve në vlerën 450.000 lekë) dhe vitit 2004 (viti i dhënies së huas)], dhe se i ndjeri S. A. dhe bashkëshortja e tij kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e shumës 5.000 euro në vitin 2011. Duke vlerësuar se nuk janë paguar detyrimet tatimore për shumën prej 191.500 lekësh [diferencë e shumës së kthyer 5.000 euro me shumën e huasë 500.000 lekë], Komisioni ka

⁵² Kontrata e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.12.2011, notere M. Sh., paraqitur nga subjekti në dokumentacionin e dorëzuar në ILDKPKI konfirmuar nga shoqëria “{***}” ShPK dhe nga arkiva e noteres.

konkluduar se *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 191.500 lekë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

22.8. Subjekti i rivlerësimit parashtron se konkluzioni i Komisionit është i gabuar. Termi “kthim huaje” nuk do të thotë se huaja është dhënë me qëllim fitimi. Në kushtet e marrëdhënies së posaçme dhe shumë të mirë, në vitet 1995-1998, familja e tij, bashkëshortja dhe vajza, si dhe ai vetë kur kthehej nga emigracioni banonin në banesën e prindërve të bashkëshortes, huaja 500.000 lekë i është dhënë atyre në trajtë ndihme për porosinë e një apartamenti, pagesën e këstit të parë, pa pasur qëllim interesi/fitimi. Prindërit e bashkëshortes me shumën e kthyer prej 5.000 eurosh dhuruan diferencën si formë ndihme kur familja e tij po blinte apartamentin në Tiranë, pasi kishin mundësi dhe likuiditete të lira [në vitin 2011 kanë shitur banesën e vjetër, vjehri përfitonte pension nga shteti grek nga viti 2000]. Për sa parashtruar, subjekti pretendon se nuk ka pasur detyrime tatimore për shumën prej 191.500 lekësh - një dhuratë/ndihmë nga familja e bashkëshortes - dhe kërkon përfshirjen e kësaj shume në analizën financiare.

22.9. Pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, si dhe aktet në fashikull, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit nuk është i drejtë. Termi “hua” në deklaratat periodike të pasurisë, në DIPP-në 2004 - *cash 500.000 lekë dhënë hua S. A.* - dhe në DIPP-në 2011 - *kthyer huaja e dhënë në vitin 2004, vlera 5.000 euro* - si dhe diferenca e shumave, në këtë rast vlerësohen në përputhje me parimin e objektivitetit, në kontekst të marrëdhënies së posaçme potencuar edhe nga fakti që në DIPP-në 2004 subjekti nuk deklaroi afat apo interesa lidhur me kthimin e shumës. Për sa nga hetimi administrativ kanë rezultuar të provuara rrethanat faktike të shpjeguara prej subjektit lidhur me marrëdhënien e huasë⁵³, mundësitë financiare të subjektit dhe familjes së bashkëshortes për të dhënë/kthyer shumat respektive, si dhe fakti se shumata 5.000 euro është deklaruar në DIPP-në 2011 si kthim huaje, nuk mund të mos konsiderohet dhënia e huasë në formë ndihme në kushtet e marrëdhënies së posaçme, dhe jo për qëllime fitimi, dhe në këtë këndvështrim edhe diferenca në shumën e kthyer si dhuratë. Në këtë këndvështrim, konsideruar faktin se në DIPP-të 2004 dhe 2011 subjekti deklaroi pjesë takuese 50% në shumën e dhënë hua, dhe atë të kthyer nga i ndjeri S. A., për shkak të marrëdhënies tejet të veçantë prind-fëmijë [babai i bashkëshortes], kthimi i një vlere më të madhe se ajo e huasë në një moment të shpenzimeve për krijimin e një pasurie bën bindës pretendimin e subjektit se diferenca me shumën e dhënë hua ka përbërë dhuratë dhe jo fitim. Në DIPP-në 2011, mosdeklarimi i shumës 5.000 euro në komponentët përbërës -kthimi i shumës së huasë 500.000 lekë dhe diferenca si dhuratë- si edhe mosdeklarimi i dhuratës në formularin përkatës, është pasaktësi në kuptim të ligjit nr. 9049/2003. Gjithashtu,

⁵³ Sipas dokumentacionit të dërguar nga AShK Gjirokastër, me nr. {***} prot., datë 19.04.2021, vërtetohet se prindërit e bashkëshortes së subjektit: (i) në datën 13.09.2011 kanë shitur shtëpinë, çmimi i shitjes 408.000 lekë; (ii) në datën 05.04.2005 kanë regjistruar në emër të tyre pasurinë apartament me sip. 59 m² në lagjen “{***}”, Gjirokastër. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti ka rezultuar se gjatë periudhës 21.08.2010 - 03.12.2011 nga llogaria bankare në Greqi në emër të babait të bashkëshortes së subjektit janë kryer disa tërheqje me vlerë totale 5.225 euro, burimi i të cilave kanë qenë të ardhurat nga pensioni në këtë shtet; gjatë periudhës 01.01.2010 - 30.11.2011, prindërit e bashkëshortes kanë përfituar të ardhura nga pensioni në Shqipëri në shumën 872.675 lekë, ndërkohë që shpenzimet jetike për të njëjtën periudhë kanë qenë 523.710 lekë.

mosdeklarimi në deklaratën e rivlerësimit i diferencës së përfituar si dhuratë përbën pasaktësi, por në rrethanat faktike dhe ligjore të sipër referuara nuk mund të prodhojë pasojë lidhur me ligjshmërinë e shumës prej 191.500 lekësh. Për sa më sipër, trupi gjykues, në zbatim të parimit të objektivitetit, çmon se me shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë bindshëm se shuma prej 191.500 lekësh përbën dhuratë të prindërve të bashkëshortes, për rrjedhojë e përfshiu atë në analizën financiare.

➤ *Pakësimi i gjendjes cash në shumën 3.000 euro*

22.10. Komisioni ka konkluduar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 3.000 euro, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion bazohet në përfundimin se në DIPP-në 2011 subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në vlerën 3.000 euro, por këtë deklaram e ka bërë përpara ILDKPKI-së në procesverbalin e datës 16.04.2015, në përgjigje të konstatimit lidhur me mosmbulimin e të ardhurave *neto* dhe pasurive *neto* për vitin 2011, për rrjedhojë analiza e Komisionit bazohet vetëm në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore, duke mos marrë në konsideratë pretendimin e subjektit për pakësim të gjendjes *cash* në vlerën 3.000 euro. Gjithashtu, Komisioni shprehet për ndryshim të qëndrimit të subjektit të rivlerësimit, pasi në procesverbalin e ILDKPKI-së, si dhe gjatë hetimit ka deklaruar se vlera 3.000 euro ka si burim likuiditetet *cash* të disponuara në fund të vitit 2010, ndërkohë që në prapësime deklaroi që burim është vlera e kthyer nga shtetasi R. S..

22.11. Subjekti i rivlerësimit parashtron se konkluzioni i Komisionit është i gabuar. Sipas tij, shuma 3.000 euro ka burim pakësimin e gjendjes *cash* në euro, e cila në fund të vitit 2010 ka qenë 5.000 euro, e deklaruar në ILDKPKI në vitin 2015, nëpërmjet DIPP-ve deri në vitin 2010 dhe saktësuar në pyetësin nr. 2, pyetja 8. Subjekti pretendon se nuk ka ndryshim të qëndrimit të tij lidhur me burimin e krijimit të shumës 3.000 euro. Në Komision ka deklaruar *se në momentin e xhirimit të shumës 10.500 euro shtetasi R. S. për blerje automjeti ka pasur gjendje cash 300.000 lekë (diferencë e gjendjes cash në fund të vitit 2010, me pagesën e këstit të fundit 700.000 lekë për apartamentin në Vlorë), 5.000 euro të deklaruar kursime deri në fund të vitit 2010, si dhe kursime të tjera familjare deri në atë moment nga të ardhurat e vitit 2011. Për blerjen e automjetit dhe transportin e tij janë shpenzuar 4.500 euro, shtetasi R. S. i ka kthyer dorazi 6.000 euro, dhe nga shuma e kthyer 3000 euro janë përdorur për pagesën e garazhit. Nga pjesa tjetër, 2.000 euro është cash e 1.000 euro është konvertuar në lekë dhe është plotësuar 300.000 lekë cash.* Duke pranuar pasaktësinë në DIPP-në 2011, lidhur me mosdeklarimin e pakësimit të gjendjes *cash* dhe duke e lidhur pasaktësinë edhe në këtë rast me keqinterpretimin e rubrikave të deklaratës, harresa nga mosdhënia e rëndësisë sa duhej apo pakujdesi në plotësimin e saj, subjekti pretendon se e ka deklaruar në ILDKPKI sapa nga ky institucion është evidentuar ky fakt, se organet e *vetting*-ut kanë konsideruar si provë deklaramin në procesverbalet e ILDKPKI-së në praktikën dhe vendimmarrjen e tyre, dhe se lidhur me kursimet *cash* ka përputhje të shifrave deri në deklaratën

e rivlerësimit të pasurisë [shifra e kursimeve *cash* e deklaruar në deklaratën *vetting* 2.000 euro, rezulton saktësisht duke i zbritur kursimeve në vitin 2011 vlerën 3.000 euro].

22.12. Trupi gjykues mori në shqyrtim këtë pretendim duke konsideruar rrethanat e posaçme të deklarimeve të kryera në lidhje me përdorimin e kësaj shume, të cilat rezultojnë të ndryshme krahasuar me ato të analizuara më sipër e që i përkasin përdorimit të shumës prej 700.000 lekësh, për financimin e kësaj të fundit për apartamentin në Vlorë. Nga analiza e DIPP-së të vitit 2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në të pagimin e shumës prej 8.000 eurosh për financimin e garazheve të blera së bashku me apartamentin në Tiranë, pa përcaktuar burimin e këtij financimi në këtë deklaratë. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në vitin 2015, subjekti ka deklaruar se si burim për pagimin e kësaj shume kanë shërbyer 5.000 euro të kthyer nga vjehri i tij dhe shuma 3.000 euro nga kursimet e krijuara në vite e të deklaruara nëpër deklaratat respektive. Këtë burim e ka deklaruar të tillë edhe në deklaratën *vetting*, duke plotësuar në këtë mënyrë deklarin e bërë në vitin 2011, për pagesën e kësaj shume. Në këtë kuptim, trupi gjykues konstaton se përcaktimi i pagesës prej 3.000 eurosh, si me burim nga kursimet në deklaratën *vetting*, lidhet me deklarin e bërë prej subjektit për pagimin e kësaj shume në vitin përkatës, në DIPP-në e vitit 2011, situatë e cila është e ndryshme nga ajo që rezultonte me shumën prej 700.000 lekësh, për të cilën nuk kishte asnjë gjurmë në deklarinet periodike as për shlyerjen e saj dhe as për burimin.

22.12.1. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues, duke pasur deklarin e qartësi për kohën e shlyerjes së kësaj shume, në vitin 2011, si edhe duke verifikuar se subjekti kishte burime të ligjshme për të krijuar kursime në këtë vlerë deri në fund të vitit 2010, vlerësoi t'i japë besueshmëri deklarin të tij në deklaratën *vetting* se kjo shumë është përdorur nga këto burime. Gjithashtu, trupi gjykues e vlerësoi këtë moment edhe në harmoni me konsiderimin prej Komisionit si të bazuar përdorimin si burim të shumës prej 5.000 eurosh të kthyer prej vjehrit, ndërsa edhe në raport me deklarinet lidhur me përdorimin e saj, subjekti kishte të njëjtat pasaktësi. Rezulton se subjekti ka deklaruar në DIPP-në e viti 2011, shtimin e të ardhurave me shumën prej 5.000 eurosh, për shkak të kthimit të huasë, por nuk e kishte deklaruar, po ashtu, përdorimin e kësaj shume si burim për pagimin e shumës prej 8.000 eurosh, ndërsa e kishte bërë këtë deklarin vetëm në deklaratën *vetting*. Komisioni, ndonëse gjendej para të njëjtave deklarin, lidhur me përdorimin e këtyre dy shumave si burime për pagimin e shumës prej 8.000 eurosh, ka përdorur një vlerësim të ndryshëm duke njohur si burim për pagimin e garazheve vetëm shumën e kthyer prej vjehrit të subjektit. Duke konsideruar edhe këtë qëndrim, trupi gjykues vlerësoi se edhe përdorimi i shumës prej 3.000 eurosh nga kursimet si burim për financimin e garazheve do të duhet të konsiderohet si i vërtetë dhe ajo të llogaritet në mesin e burimeve për krijimin e tyre.

22.12.2. Trupi gjykues e vlerësoi situatën e mësipërme edhe në këndvështrim të mënyrës së krijimit të shumës prej 3.000 eurosh, për të cilën Komisioni ka mbajtur qëndrimin se subjekti ka pasur deklarin kontradiktore, pasi një herë ka deklaruar se është krijuar nga kursimet dhe njëherë se kjo shumë është pjesë e shumës prej 6.000 eurosh të kthyer nga personi që i ka blerë atij makinën

në Gjermani. Lidhur me këtë situatë, e cila është përdorur si një argument shtesë për mosnjohjen e shumës prej 3.000 eurosh në mesin e burimeve të përdorura për financimin e garazheve, në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka parashtruar gjetjen se *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën (-) 962.598 lekë për depozitimin e shumën 10.500 euro në datën 11.10.2011 [e depozituar në llogarinë bankare të shtetasit R. S., për blerjen e pasurisë autoveturë tip Mercedes-Benz, në vlerën 3.850 euro, për të cilën do të analizohet gjerësisht në vijim]. Subjekti në parashtrime ka deklaruar se për shumën 10.500 euro, *xhiruar* për shtetasin R. S. për blerje automjeti, ka pasur gjendje *cash* 300.000 lekë (diferenca e gjendjes *cash* 1.000.000 lekë në fund të vitit 2010 me pagesën e këstit të fundit 700.000 lekë për blerjen e apartamentit në Vlorë); 5.000 euro të deklaruar si kursime në deklaratimet periodike deri në fund të vitit 2010; si dhe kursime të tjera familjare të krijuara deri në atë moment nga të ardhurat e vitit 2011. Pasi për blerjen dhe transportin e automjetit janë shpenzuar 4.500 euro, shtetasi R. S. pas kthimit nga Gjermania i ka kthyer dorazi shumën 6.000 euro, nga e cila 3.000 euro është përdorur për pagesën e garazheve, pjesa tjetër 2.000 euro është *cash* dhe 1.000 euro është konvertuar në lekë dhe plotësuar 300.000 lekë *cash*. Në procesverbalin e ILDKPKI-së, si dhe gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, për shumën 3.000 euro subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burim pakësimin e gjendjes *cash* prej 5.000 eurosh në fund të vitit 2010. Ndërsa lidhur me shumën 10.500 euro, gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet për pyetësorin standard, subjekti nuk ka dhënë shpjegim për burimin e saj. Pavarësisht pyetjes do të ishte e pritshme që subjekti në kontekst të hetimit, qëllimit të tij, të referonte burimin e kësaj shume, e cila deklarohet për herë të parë prej tij në këtë pyetësor. Për rrjedhojë, konstatohet se lidhur me disponimin e kursimeve *cash* 3.000 euro subjekti ka “përshtatur” deklaratimet në kontekst të barrës së provës së kaluar për të provuar lidhur me mundësitë e krijimit të shumës 10.500 euro, veprime të cilat kanë rezultuar më të hershme se pagesa e garazheve.*

22.12.3. Për të gjitha argumentet më sipër, trupi gjykues njohu si burim të ligjshëm shumën prej 3.000 eurosh të deklaruar nga subjekti se është përdorur prej kursimeve në vite dhe e përfshiu atë në analizën financiare të krijimit të garazheve, prej nga rezultoi se këto pasuri janë krijuar me burime të ligjshme dhe kalojnë testin e verifikimit të ligjshmërisë së tyre.

➤ *Shuma 5.000 euro, paguar në datën 13.05.2013 (për blerjen e apartamentit)*

22.13. Në DIPP-në 2013, subjekti ka deklaruar pagesën e shumës 5.000 euro për firmën “{***}” ShPK si shlyerje kësti *për banesën*, me burim krijimi nga llogaria në Alpha Bank dhe 25.000 lekë kursime. Në përfundim të hetimit administrativ, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit lidhur me *shlyerjen e huas*, Komisioni ka konkluduar se balanca e vitit 2013 rezulton pozitive në shumën 344.270 lekë dhe, për rrjedhojë, ka konkluduar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe pagesën e këstit në vitin 2013.

22.14. Subjekti shprehet se është dakord me përfundimin e Komisionit, por duke konsideruar në analizën financiare të gjithë sqarimet dhe provat e tij dhe duke llogaritur *këstin e huasë të këtij*

viti, balanca e vitit 2013 ndryshon sipas tabelës së paraqitur në ankim në vlerë pozitive prej 343.818 lekësh. Lidhur me vlerën e arredimit për vitin 2013 të llogaritur 350.000 lekë prej Komisionit, subjekti shpjegon se në analizën financiare të vitit 2013, të paraqitur në ankim në formë tabelare, nuk është llogaritur vlerë arredimi, kurse në raportin e audituesit është llogaritur 175.000 lekë, duke e pjesëtuar në mënyrë të barabartë për katër vite, në rrethanat që nuk ka dokumentacion për të provuar shpenzimet sipas gjendjes financiare për secilin vit.

22.15. Nga aktet në fashikuj konstatohet se:

(i) Në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, me të cilin i ka kaluar barra e provës se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 146.465 lekë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar balancë pozitive prej 343.818 lekësh, sipas tabelës së paraqitur [shpenzimet e jetesës janë llogaritur më të ulëta se Komisioni dhe nuk janë përfshirë shpenzimeve të arredimit], si dhe ka pretenduar se në rast se nuk konsiderohen shpjegimet e tij për huan e dhënë nga A. H. të mos përfshihet kthimi i saj në analizën financiare. Në raportin e audituesit ligjor A. M., të paraqitur si provë prej subjektit, balanca rezulton pozitive prej 28.535 lekësh dhe vlera e arredimit për llogaritet 175.000 lekë përkundrejt vlerës 350.000 lekë të për llogaritur nga Komisioni.

(ii) Lidhur me arredimin e apartamentit në Tiranë, subjekti deklaron: (i) në pyetësorin standard shpenzime në vlerën 700.000 lekë gjatë viteve 2013-2017, të cilat nuk i mban mend saktësisht [mobilimi, dhomat e gjumit, kuzhina, etj. është bërë nga shoqëria “{***}” në shumën rreth 300.000 lekë; këndi dhe trapezaria janë blerë te “{***}” për shumën rreth 150.000 lekë. Pjesa tjetër është përdorur për blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake]; (ii) në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ se shpenzimet janë bërë në vitet 2013, 2015, 2016 dhe 2017. Në periudhën tetor 2013 - tetor 2014 në apartament ka jetuar djali i motrës së bashkëshortes, në kushte minimaliste, duke marrë disa sende të domosdoshme nga familja e tij, pasi ai kishte plotësuar vetëm disa mobile kryesore, nga muaji tetor 2014 - korrik 2019 ka banuar vajza e tij, L. S., së bashku me nënën e bashkëshortes, prandaj vendosi të bënte plotësimin me arredimin e nevojshëm dhe kufizuar nga mundësitë financiare arredimi është shtyrë në periudhën 2015-2017: në vitin 2015 ka shpenzuar rreth 170.000 lekë; në vitin 2016 ka shpenzuar rreth 30.000 lekë; si dhe në vitin 2017 rreth 150.000 lekë.

22.16. Sa më sipër, lidhur me shpenzime për arredim në vitin 2013, trupi gjykues konstaton mungesë konsistence në qëndrimet e subjektit gjatë hetimit administrativ dhe në të njëjtën mënyrë, edhe në ankim. Konkretisht, fillimisht subjekti ka deklaruar shpenzime arredimi në vitin 2013, në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ i ka përjashtuar, ndërsa në provën e paraqitur me këto parashtrime - raportin e ekspertit ligjor të porositur prej tij - janë përfshirë. Me të njëjtën qasje vjen qëndrimi i tij në ankim. Pavarësisht se analiza e Komisionit në vendim nuk është e

pabazuar sa i përket shumës së shpenzuar për arredim në vitin 2013⁵⁴, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur prej Kolegjit se përgjithësisht shpenzimet e arredimit të paprovuara me dokumentacion janë pranuar në mënyrë empirike sipas shpjegimeve të dhëna nga subjektet e rivlerësimit. Pasur në konsideratë deklaratimet e subjektit *se në vitin 2013 e kishte plotësuar me disa mobilie kryesore apartamentin, që është banuar nga tetori i këtij viti dhe faktin se shumatorja e shumave të deklaruara prej tij të shpenzuara për vitet 2015-2017 është gjysma e shpenzimeve të arredimit, duket se vetë subjekti nuk e pranon shpenzimin për arredim në shumën prej 350.000 lekësh për vitin 2013. Për rrjedhojë, në analizën financiare të Komisionit për vitin 2013 shpenzimet për arredim nuk u korrigjuan.*

22.17. Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga pasqyrimi i shlyerjes së këstit të huasë prej 490.735 lekësh në analizën financiare të vitit 2013, passjell që ky vit të rezultojë me balancë negative në shumën (-) 146.465 lekë përkundrejt shumës 344.270 lekë që i ka rezultuar Komisionit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shlyerjen e shumës 5.000 euro, për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve në vitin 2013, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

➤ *Shuma 5.000 euro, paguar në datën 13.12.2014 (për blerjen e apartamentit)*

22.18. Komisioni ka konkluduar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burime të ligjshme financiare në vlerën 188.410 lekë për blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve në vitin 2014, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e të gjitha gjetjeve, për të cilat i kaloi barra e provës. Konkretisht, Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit lidhur me mospasqyrimin e shlyerjes së huasë dhe reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit, duke saktësuar shpenzimet për kartonin jeshil referuar afatit të tij dyjavor. Ndërsa ka vlerësuar të pabazuar pretendimet e subjektit lidhur me: (i) të ardhurat e bashkëshortes nga pagat në shumën 729.430 lekë përkundrejt shumës 690.730 lekë të përlllogaritur me rezultatet e hetimit, pasi diferenca mes dy vlerave është shpërblimi kredituar në vitin 2015 dhe i përfshirë në analizën financiare të vitit 2015; (ii) të ardhurat e subjektit nga pagat në shumën 1.328.060 lekë përkundrejt shumës të përlllogaritur me rezultatet e hetimit prej 1.317.061 lekësh, që përkon me shumën e pagave *neto* të kredituara në llogarinë e subjektit gjatë vitit 2014; (iii) reduktimin e shpenzimeve jetike, për sa shpenzimet bazike përlllogariten sipas të dhënave të INSTAT-it; (iv) reduktimin e shpenzimeve e udhëtimeve njëditore në Janinë; (v) moskryerjen e shpenzimeve për arredim.

⁵⁴ Në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, pasqyrohet se në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 20.3.2015, subjekti ka deklaruar se për periudhën 2003-2013 mund të ketë shpenzuar 1.000.000 lekë për pajisje, orendi dhe mobilje. Bazuar në këtë deklarin, Komisioni analizon se për vitin 2013 të jenë shpenzuar 350.000 lekë, si diferencë midis shumës 1.000.000 lekë dhe shumës 650.000 lekë të deklaruar si e shpenzuar në vitet 2009-2010 [për arredimin e apartamentit në Vlorë]. Sa më sipër, si dhe për faktin e njohur se pjesa më e madhe e shpenzimeve të arredimit (përfshirë pajisjet elektrike) janë shpenzime të cilat kryhen përpara fillimit të banimit, Komisioni ka vlerësuar që shuma e shpenzuar të ndahet në mënyrë të barabartë në vitet 2013-2014, konkretisht 350.000 lekë për secilin vit.

22.19. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i gabuar, pasi, sipas tij: (i) shpenzimet e jetesës duhet të llogariten për qytetin e Vlorës ku ka jetuar, bazuar në të dhënat e publikuara nga INSTAT; (ii) shuma 11.000 lekë e pretenduar si dieta, nëse nuk llogaritet si e ardhur duhet të zbritet nga shpenzimet jetike; (iii) shpenzimet e udhëtimit në vitin 2014 rëndohen shumë duke llogaritur vetëm kartonin jeshil 15-ditor, kur ka edhe 3 mujor në vlerën 100-120 euro, si edhe nga llogaritja e shpenzimeve të larta të qëndrimit edhe për udhëtime disa orësh në Janinë; (iv) nuk ka deklaruar shpenzime arredimi të apartamentit për vitin 2014.

22.20. Trupi gjykues, përpos konstatimit se në shkresën nr. {***} prot., datë 24.05.2011, të INSTAT-it dërguar ILDKPKI-së, të cituar në raportin e audituesit ligjor A. M., përcaktohet konsumi mesatar mujor dhe vjetor në familje dhe për frymë për vitin 2008, pa specifikuar qytet apo rajon, sjell në vëmendje të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit se shpenzimet e jetesës që përdoren nga institucionet e rivlerësimit në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste, janë mesatare dhe përfshijnë të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë, që do të thotë se ato përbëjnë një vlerë mesatare që përfaqëson një jetesë normale të një njësie familjare dhe jo shpenzime që realisht janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit, lidhur me reduktimin e shpenzimeve të jetesës, trupi gjykues i vlerëson të pabazuara. Lidhur me shumën prej 11.000 lekësh, të kredituar nga Ministria e Financave, për të cilën subjekti nuk pretendoi apo nuk paraqiti ndonjë dokument për të provuar se nuk ka të bëjë me dieta, pretendimet për zbritjen e saj nga shpenzimet jetike vlerësohen të pabazuara. Për sa arsyetuar më lart, lidhur me metodologjinë tejet garantiste të përlllogaritjes së shpenzimeve jetike në këtë proces, sillet në vëmendje se në këto shpenzime përfshihen zëra si energji elektrike, ujë etj., moskonsumimi i të cilave nuk mund të pretendohet për shkak të dietave. Lidhur me pretendimin se nga sasia e ditëve të llogaritura shpenzimet e udhëtimit janë mbi 100 ditë dhe nuk janë zbritur nga shpenzimet jetike në vitin 2014, përpos se sipas deklarimeve të subjektit janë 10 ditë që ka udhëtuar familjarisht për pushime, trupi gjykues sjell në vëmendje se këto pretendime, të trajtuara gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, janë vlerësuar të pabazuara⁵⁵. Konkretisht, të dhënat për shpenzimet jetike të publikuara nga INSTAT-i konsistojnë në vlerën e produkteve dhe shërbimeve për të plotësuar nevojat individuale të Njesisë Ekonomike Familjare, të cilat klasifikohen sipas Klasifikimit Evropian të Produkteve sipas Qëllimit (COICOP)⁵⁶, i përshtatur për Anketën e Buxhetit të Familjes në kushtet e Shqipërisë. Në strukturën e shpenzimeve për konsum të Njesisë Ekonomike Familjare, të paraqitur sipas ndarjes në 12 grupe kryesore të konsumit, nuk rezultojnë të përfshira shpenzime për turizëm, pushime jashtë vendit etj. Për rrjedhojë, në kushtet kur këto shpenzime nuk janë konsideruar pjesë e konsumit bazë, mbi të cilat INSTAT-i llogarit shpenzimet jetike, llogaritja si nën zë i shpenzimeve të kryera më vete është e bazuar. Lidhur me pretendimet për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve 1-ditore në Janinë, Komisioni ka përlllogaritur për person të rritur 20 euro dhe për një fëmijë (5-18 vjeç) koston 10 euro, përkundrajt kostove ditore

⁵⁵ Referuar vendimit të Kolegjit me nr. 34 (JR), datë 26.07.2023, subjekti i rivlerësimit G. S..

⁵⁶ *Classification of Individual Consumption by Purpose*.

të aplikuara respektivisht 50 euro dhe 25 euro pavarësisht kthimit apo jo brenda ditës dhe destinacionit. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim vlerësohet i pabazuar. Lidhur me pretendimet për shpenzimet për kartonin jeshil, që nuk ka tejkalar vlerën 400 euro/automjet për afat njëvjeçar, përpos se Komisioni nuk e ka llogaritur këtë shpenzim për udhëtimet jo me mjetin personal të subjektit, në konsiderim të prapësimeve të tij ka saktësuar vlerën duke zbritur për dy udhëtime shumë 40 euro. Pretendimin *se ka edhe karton jeshil 3-mujor në vlerën 100-120 euro*, subjekti e ngre për herë të parë në ankim, pa pretenduar se ka përdorur këtë lloj, që gjithsesi nuk do të kishte peshë në vlerën e përlllogaritur për këtë shpenzim për sa udhëtimet i përkasin periudhës shkurt 2014 - nëntor 2014. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim vlerësohet i pabazuar.

22.21. Lidhur me shpenzimet e arredimit për vitin 2014, sikundër analizuar më lart, gjatë hetimit administrativ edhe në ankim, subjekti është konsistent në deklaratimet e tij se në këtë vit nuk ka shpenzuar për arredimin. Në vlerësimin e trupit gjykues, përpos konsistencës së subjektit që qysh në deklaratimin e parë në procesin e rivlerësimit ka përjashtuar kryerjen e shpenzimeve të arredimit në vitin 2014, konsideruar se subjekti deklaroi se me shpenzimet e vitit 2013 ka krijuar kushte minimale për banim, se bëhet fjalë për një apartament të dytë që nuk përdorej për banim nga familja e subjektit, por nga vajza e subjektit studente dhe gjyshja e saj në dy muajt e fundit të vitit 2014, janë fakte që krijojnë bindjen se subjekti ka qenë i vërtetë në deklaratimin se në vitin 2014 nuk ka shpenzuar për arredimin. Subjekti pretendoi që gjysma e shumës prej 350.000 lekësh e shpenzuar për arredim në vitet 2015-2017 ose të llogaritet sipas vlerave të deklaruara prej tij ose të ndahet barazisht për secilin prej viteve, në vlerën 116.667 lekë/vit. Trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur prej Kolegjit se përgjithësisht shpenzimet e arredimit, të paprovuara me dokumentacion, janë pranuar në mënyrë empirike sipas shpjegimeve të dhëna nga subjektet e rivlerësimit. Në këtë kontekst, pasur në konsideratë deklaratimin e subjektit në fillim të hetimit administrativ se nuk i mban mend shifrat e shpenzuara në secilin vit, nga dy alternativat e pretenduara prej subjektit për kryerjen e këtyre shpenzimeve, trupi gjykues vlerëson bindës të dytin, për të ndarë shumë në mënyrë të barabartë në vitet që deklaroi se i ka bërë këto shpenzime. Për rrjedhojë, trupi gjykues, jo vetëm korrigjoi analizën financiare të vitit 2014, duke mos përfshirë shpenzimet për arredim, por korrigjoi shifrat për këtë zë në analizën financiare të viteve 2015 dhe 2016.

22.22. Në përfundim të shqyrtimit të detajuar të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, duke vlerësuar se qëndrojnë ato lidhur me shlyerjen e këstit të huasë shtetasit A. H. dhe moskryerje të shpenzimeve të arredimit, në analizën financiare të vitit 2014 u kryen korrigjimet përkatëse. Konkretisht, nga përfshirja e shlyerjes së këstit të huasë prej 490.385 lekësh dhe mospërfshirja e shpenzimeve të arredimit, analiza financiare e vitit 2014 rezultoi me balancë negative në shumë (-) 328.795 lekë përkundrejt shumës (-) 188.410 lekë që i ka rezultuar Komisionit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shlyerjen e shumës 5.000 euro, për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve në vitin 2014, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

23. Në përfundim të sa më sipëranalizuar, lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 95 m², në vlerën 60.000 euro dhe 2 garazhe në vlerën 8.000 euro, në Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e kësaj pasurie, lidhur me pagesën e kësteve në vitin 2013 dhe në vitin 2014, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

C.3. Pasuria autoveturë tip “Daimler Chrysler” (Mercedes-Benz)

24. Kjo pasuri, në deklaratën *vetting* është deklaruar autoveturë 4+1, prodhim i vitit 2004, blerë në vitin 2011, me burim kursimet familjare, regjistruar pranë DRShTRr-së Vlorë, me targa {***}, vlerë 3.850 euro, pjesë takuese 50%. Pas hetimit administrativ të kryer, referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe të konfirmuar nga DPSHTRr-ja, Komisionit i ka rezultuar se automjeti është i tipit “Daimler Chrysler C200CDI”, blerë nga shtetasi M. H., me faturë shitje në datën 13.10.2011, në vlerën 3.850 euro dhe se automjeti është me defekt në sensorin e vajit dhe ka probleme në motor. Në pyetësonin standard⁵⁷, subjekti ka deklaruar se në vitin 2011 i ka transferuar shtetasit R. S. shumën 10.500 euro dhe e ka pajisur me prokurë për blerje automjeti në Gjermani dhe ka mbështetur deklarinimin me mandatin e depozitimit të kësaj shume në datën 11.10.2011, në llogarinë e z. R. S., në NBG. Pas blerjes së automjetit, ka vijuar subjekti, diferenca i është kthyer dorazi në momentin kur i ka sjellë automjetin, për zhdoganimin e të cilit ka paguar shumën 142.800 lekë, sipas mandatit bankar të datës 27.10.2011. Në raportin për rezultatet e hetimit, përpos dyshimit mbi vlerën e vërtetë të mjetit, pasi depozitimi në bankë është bërë dy ditë përpara blerjes së tij, e se duket e vështirë që një automjet me probleme të tilla të ketë udhëtuar për distancën rreth 1.700 km, Komisioni analizon se, në çdo rast, diferenca 6.650 euro duhet të ketë qenë e përafërt me shpenzimet e riparimit, për sa kjo shumë nuk është deklaruar e kursyer në DIPP-në 2011 dhe e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare. Në përgjigje të barrës së provës së kaluar për *mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur në shumën (-) 962.598 lekë për depozitimin e shumës 10.500 euro në datën 11.10.2011*, subjekti ka deklaruar se ka pasur: gjendje *cash* prej 300.000 lekësh (diferenca e gjendjes *cash* në fund të vitit 2010 me pagesën e këstit të fundit 700.000 lekë për blerjen e apartamentit në Vlorë); shumën 5.000 euro të deklaruar si kursime familjare deri në fund të vitit 2010; si dhe kursime të tjera familjare të krijuara deri në atë moment. Subjekti ka vijuar se deklarimi i gjendjes *cash* është bërë në ILDKPKI dhe saktësuar në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, pyetja 8: se ka rënë dakord të blinte automjetin e gjetur nga shtetasi R. S., në gjendje të mirë me vlerë të ulët për shkak të defekteve të riparueshme që mund të bëheshin në Shqipëri dhe kthimin nga ky shtetas dorazi të shumës 6.000 euro, pas kthimit nga Gjermania, pasi për automjetin ishin shpenzuar 4.500 euro me gjithë transportin. Subjekti ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit lidhur me shpenzimet për riparimin e mjetit dhe për shumën e kthyer ka shpjeguar se 3.000 euro janë shpenzuar për pagimin e garazhit në Tiranë, 2.000 euro janë *cash* dhe

⁵⁷ Në përgjigje të pyetjes nr. 18 “A keni transferuar ndonjëherë ndonjë shumë të barasvlershme me 500 euro apo më të lartë në Shqipëri apo jashtë saj, jo në formë të hollash (cash) gjatë periudhës së deklarinimit? Nëse po, jepni të dhëna dhe sillni dokumentacion vërtetues”.

1.000 euro janë konvertuar për plotësim e shumës 3.000 lekë *cash*. Bashkë me parashtrimet, subjekti ka deklaraten noteriale nr. {***}, datë 24.06.2021, të shtetasit R. S.. Në përfundim, Komisioni e ka paraqitur shumën 6.650 euro si shpenzim në analizën financiare dhe ka konkluduar se *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 956.485 lekë për automjetin me targa {***}, duke u gjendur në kushtet e germës "b", të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

24.1. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit me pretendimin se është i bazuar në paragjykim, për sa automjeti është blerë në Gjermani, me kontratë të rregullt dhe nuk mund të vihet në dyshim vlera e përcaktuar në kontratë. Lidhur me përfundimin se vlera 6.650 euro është përdorur për riparimin e automjetit, subjekti pretendoi se është i pabazuar dhe i pambështetur në asnjë të dhënë të administruar, pasi shumën e shpenzuar dhe atë të kthyer e provon me deklaraten noteriale të shtetasit R. S., të anashkaluar prej Komisionit. Duke vijuar me argumentin se nuk do të kishte kuptim blerja e automjetit nëse shpenzimet për riparim do të ishin në vlerë më të lartë se çmimi i blerjes, subjekti rithekson se sjellja e automjetit në Shqipëri ka kushtuar 4.500 euro, nga të cilat 3.850 euro çmimi i blerjes dhe 650 euro shpenzime transporti. Në vijim, subjekti pretendon se edhe përfundimi i Komisionit për të paraqitur si shpenzim shumën 6.650 euro, pasi kjo shumë nuk është deklaruar si e kursyer në deklaraten e pasurisë të vitit 2011, është i pabazuar, dhe se ka pranuar pasaktësitë në DIPP sa i përket mosdeklarimit të pakësimeve të gjendjes *cash* të shpjeguara prej tij si në rastin e pagesës së kështit 700.000 lekë, për apartamentin në Vlorë. Në përfundim, subjekti pretendon se ka shpjeguar në nivel provueshmërie deklarimet e tij, të cilat duhet të pasqyrohen në analizën financiare, duke e kthyer balancën e vitit 2011 në pozitive.

24.2. Trupi gjykues konstaton se në dokumentin *kontratë shitje* të përpiluar në Gjermani pasqyrohen nënshkrimi i shitësit M. H. dhe i subjektit, në cilësinë e blerësit, ndërkohë që ky i fundit nuk ka qenë prezent, por çmon të anashkalojë këtë konstatim, në përputhje me misionin e Kolegjit për kontrollin e saktësisë së deklarimit të pasurive dhe mjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre. Mbajtur në konsideratë se në deklaraten *vetting* subjekti nuk ka deklaruar lidhur me përdorimin e shumës 10.500 euro, me qëllim blerjen e automjetit dhe as shpenzime për riparimin e defekteve për sa në tekstin e deklaratës jepet qartësi - *për deklarim të shpenzimeve të kryera në mungesë të dokumentacionit* - trupi gjykues vlerëson se pretendimi se për riparimin e defekteve shpenzimet kanë qenë të papërfillshme dhe janë bërë në Shqipëri e me pjesë këmbimi të përdorura, mbeten deklarative dhe të paprovuara. Në këtë kontekst, subjekti është kontradiktor në deklarimet e tij, teksa pretendon se automjeti është gjetur me çmim të mirë për shkak të defekteve, pretendon edhe shpenzime të papërfillshme për riparimin e tyre. Lidhur me shumën 6.650 euro [diferenca e shumës prej 10.500 euro të kaluar në llogari bankare me shumën 4.500 euro (3.850 euro për blerjen e mjetit dhe 650 euro shpenzime transporti)], argumentet e subjektit se kjo shumë nuk është përdorur për riparimin e defekteve të pasqyruara në kontratën e shitjes vlerësohen nga trupi gjykues të paprovuara e, për rrjedhojë, deklarative. Duke vlerësuar, sikundër Komisioni, se depozitimi në favor të shtetasit R. S. i shumës 10.500 euro dy ditë përpara blerjes së automjetit në Gjermani bën të besueshme se automjeti ishte përzgjedhur dhe palët kishin

rënë dakord për çmimin e blerjes dhe shpenzimet e riparimit, në të kundërt me defektet dhe problemet e pasqyruara në kontratë duket e vështirë që mjete të ketë udhëtuar nga Gjermania në Shqipëri, trupi gjykues konstaton se edhe periudha rreth 14-ditore, nga shitja e mjetit në datën 13.10.2011 dhe zhdoganimit të tij në datën 27.10.2011, nuk përjashton që defektet të jenë riparuar në Gjermani e më pas, në gjendje të sigurt, mjete të ketë udhëtuar për në Shqipëri. Gjithashtu, konstatohet se subjekti nuk deklaroi sa ka qenë shpërblimi për shtetasin R. S., i cili rezultoi se ushtron veprimtarinë e tregtimit të makinave të përdorura dhe është *porositur* për kryerjen e shërbimit të gjetjes dhe blerjes së automjetit në Gjermani. Përpos sa më sipër, në kushtet e një marrëdhënie porosie klient-tregtar, do të ishte e pritshme që nga ky i fundit shuma e pashpenzuar t'i kthehej klientit [subjektit] në rrugë bankare për dokumentimin e veprimit, sikundër edhe klienti [subjekti] kishte vepruar për dokumentimin e dhënies së saj. Lidhur me deklaratën noteriale të shtetasit R. S.⁵⁸, trupi gjykues rithekson qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit për zbehjen e forcës provuese të saj në këtë proces, pavarësisht vlefshmërisë në kuptim të ligjit “Për Noterinë”. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit për kthimin e shumës 6.000 euro nga shtetasi R. S. mbeten deklarative dhe të paprovuara.

25. Në përfundim, për pasurinë autoveturë tip “Daimler Chrysler” (Mercedes-Benz), trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të ngarkohet me shpenzimin e kryer për këtë pasuri në vlerën prej 10.500 eurosh dhe nga analizimi i mundësisë për financimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme financiare, subjekti rezultoi me balancë negative në shumën (-) 962.598 lekë, për rrjedhojë ai gjendet në kushtet e mungesës së tyre, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

C.4. Depozitë bankare në emër të bashkëshortes në vlerën 524.733 lekë, në BKT

26. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi depozitë bankare në emër të bashkëshortes në vlerën 524.733 lekë, në BKT, pjesë takuese 50%, pa deklaruar burim krijimi. Nga dokumentacioni i administruar, Komisioni ka konstatuar se kjo depozitë, me gjendje në vlerën 527.397,51 lekë e datë maturimi 20.01.2020, është krijuar në datën 18.01.2010, në shumën fillestare 400.000,72 lekë, burimi i së cilës është transferi i kryer nga shtetasi P. Ll. për këstin e dytë të apartamentit në Gjirokastër⁵⁹. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, bazuar në përfundimet për mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 563.618 lekë, lidhur me të ardhurat nga shitja e

⁵⁸ Deklaratë nr. {***}, datë 24.06.2021, notere O. K., dorëzuar nga subjekti me parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ.

⁵⁹ Sipas dokumentacionit të përcjellë nga BKT-ja, shkresa nr. {***} prot., datë 17.01.2020, nga lëvizjet e llogarive bankare konstatohet si vijon. Pjesa e këstit të dytë të apartamentit në Gjirokastër, shuma prej 3.000.000 lekësh është transferuar në datën 14.01.2009 nga shtetasi P. Ll. në llogarinë e bashkëshortes së subjektit M. S.. E gjithë shuma është kaluar në depozitë me afat, dhe pas maturimit në datën 16.04.2009, vlera prej 1.935.000 lekësh është transferuar në datën 17.04.2009 në llogarinë bankare të Sh. L. [pjesë për apartamentin në Vlorë] dhe pjesa e mbetur ka kaluar përsëri depozitë me afat, nga e cila pas maturimit në datën 28.12.2009, ka tërhequr vlerën prej 500.000 lekësh. Pjesa e mbetur prej 588.795 lekësh është kaluar në depozitë bankare, nga ku në datën 18.01.2010 është kryer një tërheqje prej 188.795 lekësh dhe shuma e mbetur prej 400.000 lekësh ka kaluar në depozitë me afat, e cila ka vazhduar deri në datën 20.01.2020.

apartamentit në Gjirokastrë dhe balancës negative prej (-) 272.593 lekësh të rezultuar nga analiza financiare e vitit 2009.

26.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit dhe pretendon se këto të ardhura duhet të konsiderohen të ligjshme, për sa ka provuar ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë, për shkak të shitjes edhe të pasurisë së luajtshme.

26.2. Lidhur me pretendimet e subjektit për ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë, trupi gjykues ka analizuar në detaje në këtë vendim, duke konkluduar se pretendimet e subjektit, se shuma për të cilën nuk janë paguar detyrimet tatimore i përket vlerës së pasurisë së luajtshme në të gjithë këndvështrimet, mbeten deklarative dhe të pambështetura në aktet e administruara në fashikuj [paragrafët 14.10-14.13]. Për rrjedhojë, duke çmuar konkluzionin e Komisionit të drejtë e të bazuar në dy balancat negative të rezultuara për vitin 2009, trupi gjykues i vlerëson pretendimet e subjektit të pabazuara.

27. Për sa më lartanalizuar, lidhur me depozitën bankare në emër të bashkëshortes së subjektit në BKT, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur gjenden në kushtet e germës “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

28. Lidhur me deklarin në deklaratën *vetting* të kursimeve *cash* në vlerat 2.000 euro dhe 300.000 lekë, me burim krijimi kursimet familjare në vite, Komisioni e ka vlerësuar si deklarin jo të saktë dhe në përputhje me ligjin, duke u gjendur në kushtet e germës “a”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

28.1. Përgjatë shtjellimit të shkaqeve të ankimit, lidhur me konkluzione të Komisionit për pasuri për të cilat ka pretenduar si burim krijimi pakësimin e gjendjes së kursimeve *cash*, sipas deklarimeve në procesverbalin e ILDKPKI-së, subjekti ka potencuar se deklarinet e tij në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike provojnë saktësinë e deklarimeve të tij për gjendjen e kursimeve *cash*. Trupi gjykues, për sa analizuar gjerësisht më lart në këtë vendim, nuk gjen të bazuar pretendimin e subjektit, i cili kërkon të argumentojë gjendjen e kursimeve *cash*, sipas një llogarie shifrash. Trupi gjykues, për të shmangur përsëritjen, nuk do të ndalet në këto pretendime të cilave i ka dhënë përgjigje në detaj. Njëherazi, duke vlerësuar të drejtë përfundimin e Komisionit se pakësimi i kursimeve *cash* i padeklaruar në deklaratat e pasurisë mbetet i paprovuar, trupi gjykues nuk e gjen të drejtë e të bazuar përfundimin e tij se do të përbënte deklarin të pasaktë në deklaratën *vetting* shifra që rezultojnë nga shuma e kursimeve *cash* të deklaruara deri në vitin 2010. Për sa në logjikën ekonomike kursimet krijohen për të mbuluar nevoja personale apo familjare për likuiditet, nuk do të ishte e arsyeshme dhe objektive të pretendohesh, pa asnjë provë, mospërdorimi i tyre nga subjekti për një periudhë 6-vjeçare. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se lidhur me vlerat e kursimeve *cash* të deklaruara në deklaratën *vetting* konkluzioni i Komisionit nuk është i bazuar.

C.5. Analiza financiare

29. Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën 1998-2016, duke konsideruar pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet, nga ku ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur kanë qenë në pamundësi për të përballuar me burime të ligjshme financiare blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vite. Në analizën financiare 1998-2016, të pasqyruar në formë tabelare në vendim, rezulton balancë negative në total prej (-) 10.243.466 lekësh.

29.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare dhe konkluzionin e Komisionit, potencon pretendimet e parashtruara me shkaqet e ankimit e të analizuara gjerësisht më sipër, konkretisht, lidhur me: (i) përfshirjen e huasë së marrë nga A. H.; (ii) shpenzimet e udhëtimeve për periudhën 2004-2016, shumica prej të cilëve në Greqi; (iii) shpenzimet për arredimin e apartamentit në Vlorë, mbulimin e tyre në vitin 2009 me pakësim të gjendjes *cash*; (iv) shpenzimet për arredimin e apartamentit në Tiranë, sipas shumave të deklaruara prej tij për vitit 2015-2017; (v) shpenzimet jetike, reduktimin e tyre sipas qyteteve ku ka jetuar. Duke pretenduar se sipas raportit të audituesit ligjor A. M., rezultati del në balancë pozitive në vlerën 2.511.434 lekë dhe se vlera e pasurisë së krijuar është 29.34 % e të ardhurave nga burimeve të ligjshme, subjekti i rivlerësimit pretendon se edhe nëse ka diferenca negative duhet të vlerësohen nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit.

29.2. Trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke reflektuar në të qëndrimin e tij, lidhur me disa nga pretendimet e subjektit të cilat u gjetën të bazuara, konkretisht: (i) ligjshmërinë e shumës së dhënë hua nga personi tjetër i lidhur A. H., nëpërmjet njohjes si burim i ligjshëm i kësaj shume, për pasojë edhe ngarkimin e analizës financiare me shpenzimet për shlyerjen e saj në vitet respektivë, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e pasurisë; (ii) përdorimin e kursimeve *cash* për pagesën pjesore të garazheve në Selitë, Tiranë; (iii) moskryerjen e shpenzimeve të arredimit në vitin 2014 dhe ndarjen në mënyrë të barabartë në vitet vijuese, i rezultoi se ai gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve për vitet 2009, 2011, 2013, 2014 dhe 2016, në total prej (-) 3.043.776 lekësh⁶⁰, sipas parashikimit në germën “ b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

30. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të

⁶⁰ Analiza financiare e Komisionit ndryshoi si vijon: (i) për vitin 2011, balanca negative u reduktua në shumën (-) 1.711.985 lekë kundrejt shumës (-) 9.218.485, si rrjedhojë e pasqyrimin të huasë të marrë nga shtetasi A. H., të kursimeve *cash* prej 3.000 eurosh për blerjen e garazheve dhe të shumës prej 5.000 eurosh kthyer nga vjehri; (ii) për vitin 2013 balanca pozitive në shumën 344.270 lekë (146.465) rezultoi negative në shumën (-) 146.465 lekë, si rrjedhojë e pasqyrimin të shlyerjes së huasë shtetasit A. H.; (iii) për vitin 2014, pavarësisht mospasqyrimin të shpenzimeve të mobilimit, nga pasqyrimi i shlyerjes së huasë shtetasit A. H. balanca negative u rrit në shumën (-) 328.795 lekë kundrejt shumës (-) 188,410 lekë; (iv) për vitin 2016 balanca pozitive në shumën 502.517 lekë (146.465) rezultoi negative në shumën (-) 19.960 lekë, si rrjedhojë e pasqyrimin të shlyerjes së huasë shtetasit A. H.. Ndërsa për vitin 2009 balanca mbetet negative në shumën (-) 836.571 lekë, sikundër në analizën financiare të Komisionit.

pasurisë dhe brenda parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi nr. 419, datë 12.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka vendosur caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, gjendet i bazuar në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit 419, datë 12.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Albert Spiro.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 05.06.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me zgjidhjen e çështjes, me vendimin nr. 28 (JR), datë 05.06.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 419, datë 12.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Albert Spiro, por kam mendim paralel lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa i përket huasë në shumën 50.000 euro, deklaruar si burim për krijimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 95 m², ndodhur në {***}, Tiranë, si dhe çmimit të shitjes së apartamentit të banimi në qytetin e Gjirokastrës.

I. Lidhur me huanë 50.000 euro

2. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaron apartament banimi me sipërfaqe 95 m², në vlerën 60.000 euro, pjesë takuese 50%, dy garazhe me sipërfaqe prej 14,57 m², me vlerë totale 8.000 euro, pjesë takuese 50%, blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, me kontratë shitblerje respektivisht me nr. {***}/*** rep/kol., datë 15.12.2014 dhe nr. {***}/***, datë 15.12.2014. Burim për krijimin e këtyre pasurive subjekti deklaron *huamarrje në vlerën 50.000 euro dhe 18.000 euro nga kursimet familjare*.
3. Lidhur me huanë në shumën 50.000 euro, Komisioni është shprehur se *nuk krijoi bindjen lidhur me marrjen e kësaj huaje, duke konsideruar: (i) faktin që nuk janë kryer tërheqje nga llogaritë bankare gjatë periudhës 01.01.2011 – 20.05.2011; (ii) vlerën e konsiderueshme të huas, 50.000 euro; (iii) periudhën e gjatë të kthimit rreth 15-vjeçare; (iv) dhënien hua të një shume të tillë pa interes; (v) dhënien hua të një shume të tillë pa dokument shkresor përpara noterit (i përpiluar vetëm pas pyetjes nga ana e ILDKPKI-së); si dhe (vi) një shumë e tillë nuk është dhënë për nevoja emergjente, por për blerjen e një shtëpie të dytë*.
4. Shumica e trupit gjykues në vendim nuk e ka gjetur të bazuar përfundimin e Komisionit *se nuk krijohet bindja për marrjen e kësaj huaje*, me argumentet se: (i) është bërë deklarimi i huasë në rubrikën detyrime, si në deklaratën periodike të vitit 2011, ashtu dhe në deklaratat periodike vjetore vijuese sa i përket shlyerjes së saj, duke i dhënë këtyre deklaratave vlerë provuese, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016; (ii) dhënia e huasë është e dokumentuar me shkresë të thjeshtë në vitin 2011, e formalizuar me akt noterial në vitin 2015; (iii) ekzistencës së marrëdhënies së posaçme mes subjektit të rivlerësimit dhe huadhënësit.
5. Pavarësisht se neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon si kusht paraprak deklarimin e marrëdhënies së huasë dhe konfirmimin e saj, përpara detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit prej personit tjetër të lidhur, në ndryshim nga arsyetimi i përdorur nga shumica e trupit gjykues, rrethanat në të cilat është marrë kjo hua e bëjnë të cenueshëm besueshmërinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe argumentet e dhëna prej tij mbi ekzistencën e kësaj marrëdhënie huaje mes tij dhe huadhënësit A. H.. Më konkretisht: (i) mosformalizimi me akt noterial i një huaje me vlerë të konsiderueshme prej 50.000 eurosh, thujtje e barasvlershme me

vlerën e blerjes së një apartamenti; (ii) një investim i tillë nuk diktohej nga nevoja emergjente, pasi në atë periudhë banonte në shtëpinë e tij në qytetin e Vlorës dhe ushtronte detyrën po në këtë qytet; (iii) shpjegimet e dhëna prej tij mbi rezultatet e hetimit administrativ se *në vitin 2011, kur interesohej për blerjen e një banese në Tiranë, për shkak se po afrohej koha që fëmijët të shkonin në universitet, ata (i referohet huadhënësve) shprehen gatishmërinë t'i ndihmonin në shumën 50.000 euro*, tregojnë se priste koha për këtë investim; (iv) pavarësisht marrëdhënies miqësore të tyre, nuk justifikohet dhënia e një shume të konsiderueshme pa një normë fitimi (interes) për një periudhë 15-vjeçare, relativisht të gjatë; (v) formalizimi i kësaj marrëdhënie në vitin 2015, vetëm pasi është pyetur nga ILDKPKI-ja, për këtë hua; (vi) fakti që nuk provohet në mënyrë të pakundërshtueshme marrja dhe dhënia e huasë, si në rastin e derdhje/transferte bankare.

6. Në bindjen time, në kushtet kur nuk provohet ekzistenca e kësaj marrëdhënie huaje, e vlerësoj të panevojshme analizën e mëtejshme të kryer për verifikimin e mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur për dhënien e huasë, në kuadër të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për sa arsyetuar më sipër, vlerësoj se shuma 50.000 euro të mos konsiderohet si burim krijimi për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 95 m², në Tiranë, duke konfirmuar kështu pamjaftueshmërinë financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2011, konstatuar nga Komisioni në vendim.

II. Lidhur me çmimin e shitjes së pasurisë apartament banimi në qytetin e Gjirokastrës

7. Nga aktet në dosjen gjyqësore të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja: -- në cilësinë e kaparmarrësit dhe kapardhënesit P. Ll. kanë nënshkruar kontratë kapari nr. {***}/*** rep/kol., datë 09.12.2008, nëpërmjet së cilës kaparmarrësit kanë përfituar shumën 3.200.000 lekë, e cila përbën një pjesë të çmimit të shitjes së apartamentit të banimit me sipërfaqe 104,9 m², në Gjirokastrë, si dhe deklarojnë se çmimi i shitjes do të jetë 6.200.000 lekë dhe pjesa e mbetur e çmimit do të likuidohet nga blerësi menjëherë pasi të përfitojë kredinë për të cilën ka aplikuar në Bankën Popullore; -- nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***}/*** rep/kol., datë 10.01.2009, të njëjtat palë kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj pasurie të jetë 4.479.230 lekë (çmimi për 1/m² është 42.700 lekë), likuiduar tërësisht; -- nëpërmjet lëvizjeve të llogarisë bankare provohet se shuma që subjekti ka përfituar nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë është 6.200.000 lekë; -- diferencën e çmimit midis kontratës përfundimtare të shitjes dhe kontratës së kaparit, subjekti e pretendon për shkak të shitjes së apartamentit së bashku me mobilimin dhe gjithë pajisjet elektroshtëpiake, ndërkohë që në kontratën e kaparit nuk parashikohet nga palët kontraktore një përcaktim i tillë, gjë që e lë këtë pretendim vetëm në nivel deklarativ; -- sa i përket deklaratës noteriale të datës 21.06.2021 të shtetasit P. Ll., Kolegji tashmë ka një qëndrim të konsoliduar lidhur me vlerën provuese të deklaratave noteriale gjatë procesit të rivlerësimit; -- sipas të dhënave të EKB-së për vitin 2008, vlera e tregut të lirë të shitjes së apartamenteve për qytetin e Gjirokastrës është 53.731 lekë/m² kundrejt çmimit 42.700 lekë/m² të përcaktuar në kontratën e shitjes. Në këto kushte, vlera e shitjes duhet të ishte 5.636.382 lekë kundrejt 4.479.230 lekë, të përcaktuar në kontratën e shitjes; -- shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me shitjen e apartamentit së bashku me mobilimin dhe gjithë pajisjet elektroshtëpiake, nuk provohen as nga deklaratat periodike vjetore dhe as nga aktet e dosjes gjyqësore.

8. Sa sipër, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, në vlerësim tim, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime fiktive, duke nënshkruar kontratën e shitjes me një vlerë prej 1.720.770 lekësh më të ulët se ajo e përcaktuar në kontratën e kaparit, me pasojë të vetme shmangien e pagesës së detyrimit tatimor për këtë shumë.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi